Mimoza Gjokutaj
Tereza Babasuli



# Fletore pune
# Gjuha shqipe 6

**Prof.dr. Mimoza Gjokutaj** **Tereza Babasuli**

# FLETORE PUNE
# GJUHË SHQIPE 6

Për klasën e 6-të të arsimit 9-vjeçar

**BOTIME**

pegi

Prishtinë, 2021

**BOTIME**

pegi

Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Redaktore letrare: Aida BARO
Korrektor: Arlon LIKO
Paraqitja grafike dhe kopertina: Elvis BEJTJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: ???

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, gusht 2021
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

**Botime Pegi:** tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
**Sektori i shpërndarjes: cel:** +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
**e-mail:** marketing@botimepegi.al
**Shtypshkronja Pegi**: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

# Hyrje

*Fletorja e punës* i shërben kontrollit të arritjeve të nxënësve në fushat përkatëse të programit të *Gjuhës shqipe 6*. Kjo fletore vjen si një zhvillim brenda paketës së re kurrikulare të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë. Ajo mbështet këtë program për njohjen dhe arritjen e kompetencave kyçe dhe atyre të fushës.

Çdo fletë pune e kësaj fletoreje lidhet me arritjet e nxënësve për konceptet: teksti letrar; teksti joletrar; gjuha figurative dhe jofigurative; kultura, kritika e historia; sistemi gjuhësor, të cilat realizohen nëpërmjet shkathtësive të komunikimit: të dëgjuarit e të folurit, të lexuarit, të shkruarit.

Secila prej fletëve të punës mban të njëjtin titull që është zgjedhur për njësinë mësimore në librin e nxënësit, në mënyrë që përdorimi i fletores të jetë sa më i lehtë si nga nxënësit, ashtu edhe nga mësuesit.

*Fletorja e punës* mbështet librin në strukturën dhe përmbajtjen e tij dhe është një dokument autentik që tregon përparimin e nxënësve, përmes të cilit ata vetëvlerësohen dhe vlerësohen, duke dëshmuar arritjet dhe progresin e tyre hap pas hapi.

Si pjesë e paketës kurrikulare, kjo fletore u vjen nxënësve e bashkëngjitur me tekstin mësimor dhe ka vlera njohëse, kërkimore dhe zbatuese.

Suksese!



# Përmbajtje

## Teksti letrar


Fuqia e Mujit 7
I lumtur është njeriu që s'ka nakar 8
Prometeu i lidhur 9
Pikat e shiut 10
Sarajet e bardha 11
Fshati i pesë kodrave 12
Droja 13
Mësuesi ynë i dashur 14
Provimi 15
Ishulli i thesarit 16
Klorela 17
Momoja dhe lodrat e reja të miqve të saj 18
Stinët në Planetin e Kuq 19
Shelgu goditës 20
Vargje kushtuar gjuhës shqipe 21
Prandvera 22
Nana 23
Më tha një plak dikur 24
Mbarim vjeshte 25
Në natyrë 26
Ne ishim, ne jemi, ne do të jemi këtu... 27
Detyrë klase 28
Mbreti Lir 29
Vdekja e një mbretëreshe 30


## Teksti joletrar


Stivi dhe problemat e matematikës 31
Dekada e Majlinda Kelmendit 32
Nexhmije Pagarusha, me zërin e saj e vulosi shekullin e njëzetë! 33
Bjeshkët e Rugovës – mirë se vini në mbretërinë e natyrës! 34
Shtatë mrekullitë e botës antike 35
Familja shqiptare dikur dhe sot 37
Rregullorja e bibliotekës së shkollës 38
Fjalimi i Adem Demaçit pas marrjes së çmimit "Sakharov" 39
Biblioteka Kombëtare e Kosovës, thesar i diturisë 40

# Njohuri për gjuhën

| | |
|---|---|
| Theksi i fjalës | 41 |
| Intonacioni dhe theksi i fjalisë | 42 |
| Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme | 43 |
| Drejtshkrimi i lidhëzave | 44 |
| Drejtshkrimi i parafjalëve | 45 |
| Fjalë të parme dhe jo të parme | 46 |
| Fjala dhe kuptimi i saj | 48 |
| Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj | 50 |
| Klasat e fjalëve | 51 |
| Emri | 52 |
| Gjinia dhe numri i emrit | 53 |
| Lakimi i emrave | 54 |
| Përshtatja e mbiemrit me emrin | 55 |
| Përemrat | 56 |
| Folja | 58 |
| Mënyrat dhe kohët e foljes | 59 |
| Zgjedhimi i foljeve në formën veprore të mënyrës dëftore | 60 |
| Zgjedhimi i foljeve në formën veprore të mënyrës lidhore | 61 |
| Zgjedhimi i foljeve në formën joveprore të mënyrës dëftore dhe lidhore | 62 |
| Ndajfolja | 63 |
| Lidhëzat | 64 |
| Parafjala | 65 |
| Teksti, paragrafi, fjalia, gjymtyra | 66 |
| Fjalia foljore dhe fjalia jofoljore | 67 |
| Fjalia dëftore dhe fjalia pyetëse | 68 |
| Fjalia dëshirore dhe fjalia nxitëse | 69 |
| Format pohore dhe mohore të fjalive | 70 |
| Fjalia e përbërë | 71 |
| Kryefjala | 72 |
| Kallëzuesi | 73 |
| Përcaktorët | 74 |
| Kundrinorët | 75 |
| Rrethanorët | 76 |
| Referenca | 77 |

# Fuqia e Mujit

**1. Lidhni me vijë sipas shembullit të dhënë.**

| | |
|---|---|
| bjeshkë | nuk e duron dot. |
| zanë | tri çifte qesh. |
| nginjet | shuan urinë, ngopet. |
| kullotë | vend me bar a me bimë, ku çohen për të kullotur bagëtia, bletët. |
| bari | mal i lartë me kullota verore. |
| oshtin | ushton, lëshon një zhurmë të mbytur e të fuqishme. |
| mërzen | pushon në hije në kohën e vapës. |
| e ka halë në sy | ai që ruan e kullot bagëtinë, çoban. |
| rrogëtar | shkëmb i ashpër me thepa. |
| shtat | trupi i njeriut nga koka deri te këmbët. |
| tri pendë qe | dikush që paguhet me një rrogë të caktuar. |
| prehem | çlodhem. |
| gërxh | vend i freskët e me hije ku kalojnë vapën bagëtia. |
| vikat | figurë e besimeve popullore shqiptare, e përfytyruar si vajzë shumë e bukur, që jeton në male e pyje dhe u jep ndihmë trimave, por që ka edhe fuqi për të ndëshkuar duke shituar. |
| shushërin | fëshfërin. |
| këndell | bërtet. |
| mriz | i jep fuqi e gjallëri dikujt, përtërin. |

**2. Shkruani një tekst të shkurtër me temë: "Sikur të isha Muji i fuqishëm për një ditë...".**

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

# I lumtur është njeriu që s'ka nakar

**1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Krahasimi është ajo figurë _______________, e cila krijohet nga vënia ballë për ballë e dy sendeve, dy _______________ ose dy dukurive për të ndriçuar më mirë _______________, si dhe për ta bërë më të gjallë e më të pasur _______________. Nga ndërtimi sintaksor, krahasimi ka dy pjesë: të krahasuarit dhe _______________, që lidhen ndërmjet tyre me lidhëzat: si, _______________, porsi, _______________.

**2 Përgjigjuni me shkrim pyetjeve të mëposhtme.**

Çfarë dija më parë rreth kësaj përralle?

____________________________________________________________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

Çfarë mësova rreth saj?

____________________________________________________________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

Çfarë dua të mësoj më tej rreth kësaj përralle?

____________________________________________________________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

3. Shkruani përshtypjet që ju la fundi i përrallës.

____________________________________________________________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

# Prometeu i lidhur

**1 Lidhni me vijë sipas shembullit të dhënë.**

| | |
|---|---|
| Skithi | çekan i madh hekuri për të thyer gurë, për të rrahur hekurin e skuqur. |
| Hefesti | copë druri a metali, e mprehtë nga njëra anë, që përdoret për të çarë drutë, duke e goditur me vare. sipas përfytyrimeve të lashta, eteri ishte një lëndë që zinte gjithë hapësirën mbi atmosferë. |
| Pushteti | një nga perënditë e Olimpit, servile e Zeusit, zbaton verbërisht urdhrat e tij. |
| vare | sipas përfytyrimeve të lashta, eteri ishte një lëndë që zinte gjithë hapësirën mbi atmosferë. |
| pykë | një nga perënditë e Olimpit; perëndia e zjarrit, e zejeve të ndryshme, e artit dhe e metalurgjisë. |
| tiran | sundimtar i vetëm e me pushtet absolut që qeveris me dhunë. |
| eter | vend në veri të Detit të Zi, në Kaukaz. Prometeun e mbërthejnë në një mal të Skithisë. |

**2 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Epiteti është një fjalë ______________, e cila formohet me një mbiemër që i shtohet një ______________ për t'i pasuruar kuptimin, duke i dhënë bukuri artistike dhe ____________________. ______________ është një figurë letrare me përdorim shumë të gjerë, që shpesh bëhet edhe përcaktues i stilit të një autori.

**3 Pjesa "Prometeu i lidhur" përfundon me fjalët:**

Zeusi ashtu siç kërcënoi, po ashtu veproi. Dërgoi një shqiponjë që ia hante mëlçinë Prometeut. Por natën mëlçia rritej përsëri, ditën tjetër shqiponja zbriste dhe e hante, e njëjta gjë përsëritej. Afro katërqind vjet vazhdoi kjo torturë e Prometeut.

Shkruani një mbyllje tjetër për këtë pjesë.

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

# Pikat e shiut

**1** **Duke u nisur nga ngjarja e rrëfyer në këtë pjesë, reflektoni rreth përballimit të rreziqeve të papritura. Për çfarë kemi më shumë nevojë në situata të tilla? Përshkruani një ngjarje të jetuar ose të dëgjuar.**

# Sarajet e bardha

**1** **Shpjegoni me fjalë të tjera shprehjet e renditura më poshtë.**

nuk kishte mbetë vend as për nji pulëbardhë

___

mbetën bukur larg atyne të huejve të tjerë

___

Hëna ngadalë e qiti kambën mbi kodër

___

Vala u prarue n'argjend

___

Atje e kanë kurdisë trollin

___

Turistët kishin vërshue brigjeve t'Adriatikut

___

si me dashtë me e zanë verën për të mos e lëshue ma

___

**2** **Reflektoni rreth fjalisë së mëposhtme, duke e lidhur me histori të jetuara ose të dëgjuara.**

Në dhe të huej, ku njeriu e ndien veten si të humbun dhe shumë ma të vogël se sa asht, asht miqsi e madhe kur të flet dikush dhe të kupton.

___

___

___

___

___

___

___

___

# Fshati i pesë kodrave

**1** **Sipas jush, ky është një tekst letrar apo joletrar? Pse? Në këtë tekst, mesazhi përcillet si informacion apo si ndjesi?**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**2** **Në këtë fragment mungon dialogu mes personazheve. Duke iu referuar fjalive të shkëputura më poshtë, ndërtoni dialogë, të cilët mund të integrohen në fragment.**

Dita në atë katund malor, ku gati kurrë nuk shkelte këmbë e huaj, përpos ndonjë miku, që rrallë herë shihej atypari, ishte shumë e qetë. Njerëzit shpërndaheshin në punë së bashku me agimin e çdo dite.

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

Ditëve të verës mund të dëgjohej prej së largu, vetëm herë pas here, ndonjë zile kafshe ose blegërimë e ndonjë deleje e ndarë nga tufa, e që herë-herë përzihej me zërin e barinjve, me jehonat që kumbonin thekshëm përrua pas përroi, duke e përcjellë zërin derisa humbte në lartësi.

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

Mbrëmja ishte edhe më e gjallë. Njerëzit ktheheshin nga puna, ndaleshin në mes të katundit dhe bisedonin deri vonë.

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

# Droja

1 Duke u nisur nga përshkrimi dhe evoluimi i personazhit të Artanit, përshkruani shkurtimisht një shokun ose shoqen tuaj që ngjan me të. Në fund, mos harroni të shkruani se përse ju pëlqen ai/ajo.

2 Duke u nisur nga përshkrimi dhe evoluimi i personazhit të Shkëlzenit, përshkruani një shokun ose shoqen tuaj që ngjan me të. Në fund, mos harroni të shkruani se përse ju pëlqen ai/ajo.

# Mësuesi ynë i dashur

1 Përshkruani mësuesin/en tuaj të parapëlqyer. Fillimisht ndaluni te paraqitja e tij/saj jashtme dhe, më pas, përshkruani sjelljen e tij/saj dhe marrëdhënien që keni me të, duke shprehur gjykimin dhe vlerësimin tuaj.

# Provimi

**1** **Plotësoni hartën e ngjarjes për këtë tregim.**

**Koha:**

**Vendi:**

**Personazhet:**

**Problemi:**

Albertinoja duhet të bëjë një ese në të cilën i kërkohet portretizimi moral i prindërve.
Ai i bën pyetje të sikletshme babait.

**Ngjarjet:**

**Zgjidhja:**

# Ishulli i thesarit

**1 Lidhni me vijë sipas shembullit të dhënë.**

| | |
|---|---|
| kuvertë | hekur i rëndë me ganxhë që lëshohet në det. |
| ekuipazh | trup si hinkë e përmbytur. |
| kon | sheshi i sipërm i anijes. |
| spirancë | njeri i trishtuar, që është i pakënaqur nga jeta. |
| zgurdulloi | të gjithë ata që drejtojnë anijen dhe kujdesen për të. |
| sënduk | ndjek me vëmendje. |
| pretekst | të gjesh një arsye. |
| mendjeshkurtër | arkë prej druri me kapak. |
| vëzhgoj | iu hapën sytë fort. |
| pesimizëm | dikush që nuk mendon thellë. |

**2 Shkruani një tekst të shkurtër me temë "Nga njëra aventurë në tjetrën". Kujdesuni që të përcillni mesazhe lidhur me guximin, vullnetin dhe vetëbesimin.**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

# Klorela

**1** **Shpjegoni me fjalë të tjera shprehjet e renditura më poshtë.**

qyteti po i përcillte me zemër të ngrohtë

______________________________________________

u nis me vërtik

______________________________________________

fluturonte me shpejtësi fantastike

______________________________________________

tavolina e ngrënies u shtrua me të gjitha të mirat

______________________________________________

**2** **Inxhinieri e përshkruan në formë enciklopedike bimën e Klorelës: "Klorela njihet si bimë uji. Ka vlera të mëdha ushqyese. Trupi i saj përmban 50% albumina, 20% yndyrë, 20% karbohidrate dhe vetëm 10% mbeturina të ndryshme. Kur i krijohen kushte të mira, shtohet 8 herë në 24 orë. Në prodhimtari nuk mund të krahasohet me asnjë bimë tjetër. Nga një bimë, me shpejtësi të çuditshme rriten dy të tjera, nga këto rriten katër, tetë e kështu me radhë".**

Cili është qëllimi i këtij përshkrimi?

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**3** **Kjo pjesë letrare përfundon me njoftimin e dërguar në Tokë: "Anija kozmike "Flumina" u ul me sukses në Mars. Ekuipazhi në gjendje shumë të mirë. Eksperimentimi me Klorelën i suksesshëm". Në këtë njoftim mungojnë detajet, gjë që dëshmohet edhe nga prania e fjalive pa folje. Përse ndodh kjo?**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

# Momoja dhe lodrat e reja të miqve të saj

**1** **Renditni lojërat që keni krijuar me sendet e shprehura nga fjalët e nënvizuara:**

"Ndaj fëmijët u ktheheshin përsëri lojërave të tyre të vjetra, për të cilat mjaftonin disa kuti, ndonjë copë e grisur pëlhure, ndonjë pirg dheu apo ndonjë grusht me guralecë".

Shtoni të tjera, duke nxjerrë në pah sendet që keni përdorur.

**2** **Kujtoni lojën që ju emociononte më shumë kur ishit të vegjël. Shpjegoni pse me të "mund ta fantazoje çdo gjë vetë".**

# Stinët në Planetin e Kuq

**1** **Në tekst, plani ditor i punës së Presidentit përshkruhet tejet i ngarkuar. Lexuesit i bëhen të ditura dy pikat e para të këtij plani:**

1. Mbledhja e Asamblesë së kalamajve për të vendosur radhën e stinëve.
2. Takimi i Presidentit me kalamajtë e Tokës, të ardhur në Mars me autobus kozmik...

Shtoni dy pika të tjera, të cilat mendoni se mund të jenë në përputhje me planifikimin e kësaj dite të Presidentit të Planetit të Kuq.

**2** **Në fund të Asamblesë së kalamajve u votua rezoluta që lidhej me tekat e tyre. Duke mbajtur parasysh që rezoluta është vendim me shkrim që merret në fund të një mbledhjeje, shkruani tekstin që mund të ketë pasur ajo.**

# Shelgu goditës

**1** **Në frazat e mëposhtme, nënvizoni krahasimet. Dalloni pjesët përbërëse të secilit prej tyre: të krahasuarit, krahasuesin dhe lidhëzën me të cilën janë lidhur.**

u futën me vërtik mes reve të ulëta dhe të dendura si shtëllunga leshi

gjithçka u bë e murrme dhe si e veshur

Ekspresi i Hoguortsit po shkiste nën të si një gjarpër flakë i kuq.

makina bëri mbrapsht si shigjetë

**2** **Në momentin që makina fluturuese del jashtë kontrollit të Ronit dhe Harrit, mes tyre zhvillohet ky dialog:**

"– NDALU! NDALU! – thirri duke goditur kroskotin dhe xhamin e përparmë, por rënia kryengulthi nuk u ndal dhe toka poshtë po afrohej me vërtik.

– KUJDES ATË PEMË! – thirri Harri, duke u përpjekur të kapte timonin, por qe shumë vonë...

BUM!"

Si mendoni, për ç'qëllim autorja ka vendosur t'i paraqesë disa nga fjalët e këtij dialogu me shkronja të mëdha? A justifikohet nga ana drejtshkrimore një përdorim i tillë? Po nga ana artistike?

# Vargje kushtuar gjuhës shqipe

**1** **Lidhni emrin e poetit me vargjet e shkruara prej tij.**

| | |
|---|---|
| Të falem ty, O gjuhë shkrepëtim,<br>që shkrep në qiej e vrungullon... | Naim Frashëri |
| ...porsi vala e bregut t'detit,<br>porsi gjâma e rrfès zhgjetare,<br>porsi ushtima e nji tërmetit,<br>ngjashtu â' gjuha e jonë shqyptare. | Lasgush Poradeci |
| Kjo 'shtë mëm' e mirësisë,<br>Që bije qytetërinë,<br>Gasthin e vëllazërisë,<br>Njerëzin' e miqësinë. | Ndre Mjeda |
| Kjo gjuhë martire,<br>Lehonë e përjetshme,<br>Që lindi mes dhembjesh,<br>Art i të pavdekshmëve. | Gjergj Fishta |
| Përmbi za që lshon bylbyli,<br>gjuha shqipe m'shungullon<br>përmbi er' që jep zymbyli,<br>pa da zemrën ma ngushllon. | Mitrush Kuteli |
| O gjuhë-e shenjtëruar, o mall me shpirt plot.<br>O vetëtim' e qiellit që fërfëllon me flakë,<br>O djellë-i llaftaruar që ndrin si pikë lot... | Ismail Kadare |

**2** **Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Figura letrare e apostrofit është ndërhyrja __________________ me anën e së cilës thërrasim pranë gjërat __________________ ose të afërta, të gjalla a të vdekura, që t'i bëjmë __________________, konkrete dhe që të ndikojmë kështu në ndjenjat e __________________ e të tjerëve.

**3** **Bëni një pesëvargësh për gjuhën shqipe.**

Gjuha shqipe

[ ] + [ ]

[ ] + [ ] + [ ]

[ ]

[ ]

# Prandvera

**1** **Reflektoni rreth strofës së mëposhtme duke e lidhur me ndjesitë që ju shkakton ardhja e pranverës dhe me peizazhin e krijuar prej saj në vendbanimin tuaj.**

*Fllad i let me vapë dashnijet*
*Puthi pemën gemb* për *gemb;*
*U zgjue pema, e qe prei shijet*
*Buloj mbarë nëpër kopshte tem.*

# Nana

**1** **Shkruani tekstin e korrigjuar të përshkrimit që i bëtë marrëdhënies që keni me nënën. Në fund, evidentoni gabimet drejtshkrimore më të përsëritura.**

Gabime drejtshkrimore të përsëritura:

# Më tha një plak dikur

**1** **Duke u nisur nga këshillat që më i moshuari jep për jetën në tërësinë e saj, shkruani pesë këshilla drejtuar fëmijëve që së shpejti do të shkojnë në shkollë për herë të parë.**

**2** **Rishkruani këshillat e mësipërme duke ruajtur idenë, por duke e shprehur atë me fjalë të tjera. Kujdesuni që të gjeni fjalë, të cilat rimojnë me ndonjë nga fjalët e secilës këshillë.**

**3** **Provoni të rimoni këshillat e shkruara në ushtrimin 2, me njëra-tjerën. Si tingëllojnë ato?**

**4** **Bëni një pesëvargësh për këshillat.**



# Mbarim vjeshte

**1 Lidhni me vijë sipas shembullit të dhënë.**

| | |
|---|---|
| shtërg → | lejlek. |
| plorësh | vijë e gjatë, që hapim në arë me plug ose me një vegël tjetër bujqësore. |
| brazdë | të punuar. |
| të rrëxuar | moçalishte. |
| ugar | zog shumë i vogël, i ngjashëm me trumcakun, që ka ngjyrë të murrme dhe që rri nëpër ferra. |
| blatishtë | zog i madh shtegtar si pelikani, i përhimë e me sqep të shkurtër. |
| çoçërr | pjesa e hekurt që vihet në majë të parmendës. |
| krilla | tokë e punuar, e bërë gati për t'u mbjellë. |

**2 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Aliteracioni është përsëritja e bashkëtingëlloreve ________________ ose e togjeve __________________ të njëjtë. Kjo figurë letrare vërehet veçanërisht në _______________ dhe rrit fuqinë ___________________të tyre.

**3 Shkruani strofa sipas modelit të dhënë.**

<table>
<tr>
<td>
Vjeshta<br><br>
U zhduk vapa shkoi vera<br>
dhe bilbili më s'këndon,<br>
erdhi vjeshta me të tjera,<br>
syri ynë që i shikon.<br><br>
Teret koha, hapen retë,<br>
ngjyrë plumbi përsëri,<br>
duket prapë tjetër jetë,<br>
që natyra ndërron tashti.<br><br>
Era fryn, fletët bien,<br>
pemët zhvishen si nga mot,<br>
mali, fusha më s'ka hijen,<br>
që e kishte gjer më sot.<br><br>
Bukuritë janë zhdukur,<br>
shiu e bryma zuri vend,<br>
bari, lulet, kopshti i bukur<br>
u ndryshuan në çdo kënd.<br>
Asdreni
</td>
<td>
Shkruajmë një strofë për vjeshtën:<br>
______________________________A<br>
______________________________B<br>
______________________________A<br>
______________________________B<br>
Shkruajmë një strofë për pranverën:<br>
______________________________A<br>
______________________________A<br>
______________________________B<br>
______________________________B<br>
Shkruajmë një strofë për verën:<br>
______________________________A<br>
______________________________B<br>
______________________________B<br>
______________________________A<br>
Shkruajmë një strofë për dimrin:<br>
______________________________A<br>
______________________________B<br>
______________________________B<br>
______________________________A
</td>
</tr>
</table>

# Në natyrë

**1** **Gjeni në poezi dhe shkruani vargjet që:**

- tregojnë kohën së cilës i referohet poeti në këtë poezi.

______________________________

______________________________

______________________________

- tregojnë dëshirën për t'iu larguar qytetit.

______________________________

______________________________

______________________________

- himnizojnë bukurinë e natyrës.

______________________________

______________________________

______________________________

**2** **Gjeni dy fjalë të poezisë që ju pëlqejnë më shumë. Shkruani dy vargje për secilën.**

______________ ______________

______________ ______________

**3** **Çfarë përfytyrimi krijoni për vendin të cilit i referohet kjo poezi? Përshkruajeni shkurt atë.**

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

______________________________

# Ne ishim, ne jemi, ne do të jemi këtu...

**1** **Duke iu referuar poezisë së Qerim Ujkanit dhe mesazheve që ajo përcjell, shkruani një tekst me temë "Kosova ime".**

# Detyrë klase

**1** **Reflektoni rreth vargjeve të fundit të kësaj poezie:**

*... dhe muret e klasës*
*shemben pa zhurmë:*
*xhamat prapë bëhen rërë,*
*boja bëhet ujë,*
*bankat bëhen pemë,*
*shkumësi bëhet gur,*
*pena bëhet zog.*

**2** **Duke u nisur nga kjo poezi, reflektoni rreth raportit mësime - lojë. A duhet shmangur loja, kur jemi në shkollë? Po mësimet, kur jemi me pushime?**

# Mbreti Lir

**1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Tragjedia është një lloj dramatik i shkruar kryesisht ________________. Në antikitet, tema e tragjedisë u mor nga ______________, kurse kori luante një rol të rëndësishëm. Aktorët visheshin ______________________ dhe mbanin maska. Më vonë, tematika mitike u zëvendësua nga tematika ________________ ose nga tematika _______________________.

**2 Nisur nga mënyra se si e shtron pyetjen mbreti Lir:**

*Cila nga ju na do më shumë, vallë?*
*Që ashtu darovën tonë më të pasur*

- interpretoni përgjigjet e Gonerilës dhe të Reganës, duke i krahasuar me njëra-tjetrën.

| Përgjigjja e Gonerilës | Përgjigjja e Reganës |
|---|---|
| Imzot, ju dua më fort se shprehin fjalët,<br>Më fort se syt, hapsirën e lirinë,<br>Më shumë se çdo gjë që mund të çmohet<br>Për pasurinë dhe rrallësinë e saj;<br>Dhe jo më pakë nga sa dua jetën<br>me hir, shëndet, e bukuri dhe nder;<br>ju dua aqë fort sa asnjë fëmi<br>*nuk i ka dashur prindët gjer tani,*<br>*me dashuri q'as fryma s'është e mjaftë*<br>*As gjuha s'është e zonja ta tregonjë –*<br>*Ju dua ca më shumë nga sa thashë.* | *Im atë,*<br>*Jam mbrujtur prej një brumi si ime motër,*<br>*Dhe kam të njëjtën vlerë. Zemrën e dlirë*<br>*Ma thonë, se ime motër ju ka shprehur*<br>*Të gjithë dashurinë që ndjej unë;*<br>*Po mbeti tepër prapa, sepse vetë*<br>*Armike jam për gjith'ato* gëzime<br>*Që rrjedhin si pasoja t'epshevet,*<br>*Dhe ndjenj se s'jam e lumtur veç se vetëm*<br>*Në dashurinë e Madhërisë suaj.* |

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

**3 Si tingëllon përgjigjja e Kordeljas?**

*E mjera, s'jam e zonja të ngroh zemrën.*
*Në cep të gjuhës. Madhëri, ju dua*
*Ashtu si e ka detyrë çdo fëmijë*
*Ndaj t'et, dhe as më shumë as më pakë.*

______________________________________________________________

______________________________________________________________

Çfarë duhet të kishte kuptuar mbreti prej saj?

______________________________________________________________

# Vdekja e një mbretëreshe

**1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Monologu i brendshëm është pjesë e një vepre letrare, që përmban bisedën e personazhit me ________________, duke shprehur në këtë mënyrë mendimet e ________________, jetën e brendshme dhe gjendjen shpirtërore. Monologu i brendshëm rrit ________________.

Monodrama është një vepër dramatike, që shfaqet si ________________. Në këto vepra dramatike zakonisht nuk ka shumë veprime, teksti shfaqet si ________________ ose si një shfaqje e asaj që ndodh në botën ________________ shpirtërore të protagonistit.

**2 Interpretoni pjesëzat e shkëputura nga monologu i Teutës. Çfarë vini re nga njëra pjesëz në tjetrën?**

*Keni kaluar shtrëngatat, detet dhe shkëmbinjtë që të pushtoni tokat e mia. Mendoni se këtu do të gjeni qetësinë? Keni harruar se qetësia juaj do të varet prej nesh, ashtu siç varet gjithmonë paqja e pushtuesit prej durimit të të pushtuarit.*

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

*Përmbi malet tona fluturojnë shqiponjat dhe prej tyre jemi mësuar të çmojmë mbi çdo gjë tjetër lirinë. Edhe buka na duket e ëmbël, edhe gruri na duket i butë; edhe malet na duken fusha; edhe dimri na duket pranverë vetëm kur jemi të lirë.*

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

*Kam parë dashurinë edhe atje ku ka qenë urrejtja – si gjithnjë; besnikërinë edhe atje ku ka qenë tradhtia – si gjithnjë. Kam zgjatur dorën që të më nxirret krahu – si gjithnjë; më është dhuruar buzëqeshja e është shikuar froni – si gjithnjë. Unë e vdekur, derisa të tjerët do të jetojnë. Vetëm...*

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

# Stivi dhe problemat e matematikës

**1** **Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Teksti rrëfyes është një lloj ________________, në të cilin autori rrëfen duke u bazuar në një ndodhi ________________. Personazhet janë ________________, ashtu sikurse vendet, koha dhe ngjarjet. Në këtë lloj shkrimi përfshihen: intervistat, autobiografitë, ________________, kujtimet, ________________, mbresat, reportazhet, ________________, kronikat etj. Rrëfimi gërshetohet me përshkrimin e hollësishëm, ________________ dhe informimin nëpërmjet fakteve. Fjalitë janë ________________ dhe të qarta, me përdorim të kursyer të ________________.

Biografia është përshkrimi i jetës së ________________, me të dhënat për ________________ dhe për veprimtarinë e tij. Biografia përfshin jo vetëm faktet themelore (lindja, ________________, familja, puna, karriera, ________________, vlerësimet dhe vdekja), por edhe përvojën e personit rreth këtyre ngjarjeve. Ajo shkruhet nga një ________________ (biograf), i cili mbledh ________________ rreth personit për të cilin po shkruan një biografi. Këto të dhëna mund të jenë ________________________________, letra, letërkëmbime, ________________, filmime, intervista me njerëz ________________ ose që e kanë njohur personin për të cilin po hartohet ________________ në fjalë.

**2** **Në vijim paraqiten citimet e Xhobsit, të shkëputura nga fragmenti i biografisë së tij, që flet për fëmijërinë dhe sidomos për jetën në shkollë.**

**Deri në klasë të tretë**

*Kisha një shok të mirë që e quanin Rik Ferrentino dhe, bashkë me të, jam futur në lloj-lloj telashesh.*

*Për shembull, bënim postera* të vegjël ku shkruhej: *"Nesër sillni kafshët në shkollë." Ishte çmenduri me tërë ata qen që ndiqnin macet, ndërsa mësuesve u ziente koka.*

*Një herë, bindëm disa fëmijë të na tregonin kombinimet e çelësave të biçikletave. Dolëm jashtë dhe ndërruam kodet, pastaj asnjëri nuk merrte dot biçikletën e vet. Iu desh të rrinin deri në darkë sa t'i gjenin.*

**Në klasë të katërt**

*Një ditë pas shkolle, [mësuesja e klasës së katërt] më dha një libër ushtrimesh me problema matematike dhe më tha: "Dua që ta marrësh me vete këtë e t'i zgjidhësh të tëra." Kurse unë mendova: "Mos ke luajtur mendsh?" Pastaj ajo nxori një nga ato lëpirëset e mëdha që dukej sikur nuk mbaronte kurrë dhe tha: "Kur t'i mbarosh ushtrimet, nëse i ke zgjidhur mirë, do të të jap këtë bashkë me pesë dollarë." Ia ktheva brenda dy ditësh.*

*Prej saj mësova më shumë se nga çdo mësues tjetër dhe, po të mos qe për të, do të kisha përfunduar në burg.*

*Në klasën time, ajo kujdesej vetëm për mua. Shihte diçka tek unë.*

- Krahasoni citimet e pjesës "Deri në klasë të tretë" me ato "Në klasë të katërt". Shpjegoni arsyet e ndryshimit që vihet re në sjelljen e Stivit dhe reflektoni rreth marrëdhënies së tij me mësuesen e klasës së katërt, duke e krahasuar edhe me marrëdhënien që keni ju me njërin prej mësuesve.

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

# Dekada e Majlinda Kelmendit

**1** **Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Kronika është një lloj shkrimi, që u kushtohet ______________________________nga një fushë e veçantë e jetës ose e ______________________________. Në të rrëfehen fakte që kanë ndodhur ______________. Informacioni që jep ajo, _____ pyetjeve: Kush? Çfarë? ______________? Kur? ______________? Si? Në përgjithësi, kronikat janë shkrime ______________, por të strukturuara mirë, ku dallohen mirë data, ______________, situata, ______________.

**2** **Shkruani një kronikë për fitoren e medaljeve të arta nga xhudistet Distria Krasniqi dhe Nora** Gjakova në Lojërat Olimpike "Tokio 2021".

# Nexhmije Pagarusha, me zërin e saj e vulosi shekullin e njëzetë!

**1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Intervista është një ____________________ në formë pyetje-përgjigjesh midis dy individësh për çështje ____________________ që mbështeten në fakte dhe në ____________________ të folësve. Intervista synon të njohë ____________________, qëndrimet, ____________________, përvojat dhe ____________________ e të intervistuarit. Intervista mund të jetë: a. e strukturuar; b. ____________ _________; c. e lirë.

**2 Gjeni fjalë të tjera, sinonime me fjalët e nënvizuara, në mënyrë të tillë që shprehjes të mos i ndryshojë kuptimi.**

Tash po e shoh sa më vështirë ka qenë atëherë

_______________________________________________

*kam pasur një grusht njerëzish,* të cilët më kanë ndihmuar shumë, *më kanë inkurajuar*

_______________________________________________

*Unë pajtohem me konstatimin se kjo është kryevepër*

_______________________________________________

çdo *shpërblim ka qenë një moment i rëndësishëm për punën*

_______________________________________________

*vetëm me angazhim* të madh mund të ndërtojmë një shtet që *u ka hije shqiptarëve*

_______________________________________________

**3 A është informues dhe nxitës titulli i intervistës? Nëse do të ishte në dorën tuaj, si do ta kishit titulluar ndryshe këtë intervistë?**

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

# Bjeshkët e Rugovës – mirë se vini në mbretërinë e natyrës!

**1** **Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Udhëpërshkrimi është një lloj i veçantë i ____________________________. Ai është një prej gjinive _______________ dhe më me ndikim të shkrimit. Ky lloj publicistik ka lindur nga __________________ e njerëzve nëpër vende të ndryshme dhe nga ____________________ që kanë lënë ata. Udhëpërshkrimi është përshkrim dhe rrëfim ____________________ i viseve, njerëzve dhe ngjarjeve, si dhe i temave që lidhen me një ____________________. Udhëpërshkrimi sjell të dhëna të plota, ____________________, njerëz, ____________________, mendime, ____________________, emra e deri edhe elemente fantastike apo ____________________.

**2** **Gjeni fjalë të tjera që janë sinonimike me fjalët e nënvizuara, në mënyrë të tillë që shprehjes të mos i ndryshojë kuptimi.**

që mund të kryesojnë listën e destinacioneve tërheqëse kosovare

_____________________________________________________________________

është treguar vërtet *bujare me këtë vend*

_____________________________________________________________________

*ju presin në zemër* të dimrit

_____________________________________________________________________

*Pjesën dërrmuese* të popullatës e përbëjnë kelmendasit

_____________________________________________________________________

**3** **A mendoni se është i mjaftueshëm aq informacion sa përmban ky tekst rreth Bjeshkëve të Rugovës? Argumentoni përgjigjen tuaj.**

_____________________________________________________________________

_____________________________________________________________________

_____________________________________________________________________

_____________________________________________________________________

_____________________________________________________________________

_____________________________________________________________________

_____________________________________________________________________

_____________________________________________________________________

_____________________________________________________________________

# Shtatë mrekullitë e botës antike

**1** **Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Teksti informues-paraqitës është një tekst që paraqet ____________________, data dhe __________________, duke i shpjeguar në mënyrë të qartë dhe korrekte. Çdo paragraf i tij përmban informacione _______________ dhe shpesh shoqërohet me ________________________, si: fotografi, ____________, harta, ____________ etj. Informacioni përcillet te lexuesi në forma të ndryshme ____________________, si nëpërmjet _____________ të shkruara dhe atyre televizive, enciklopedive, _______________, gazetave etj. Tekste shpjeguese-informuese janë: artikujt, ___________________, broshurat, __________________, vërtetimet, __________________, raportet vjetore, ______________________, letrat zyrtare, ______________, shpalljet, _______________, etiketat etj. Në këtë lloj teksti përdoret gjuha standarde, si dhe _____________________, sipas fushës për të cilën bën fjalë teksti. Nuk përdoret _________________________________.

**2** **Çfarë kuptimi kanë fjalitë e mëposhtme? Qarkoni alternativën e saktë.**

*[Piramida e Keopsit] E vetmja mrekulli për të cilën nuk biem pre e spekulimeve për sa i përket pamjes, madhështisë dhe formës së saj.*

a) Autori i tekstit shqetësohet për spekulimet lidhur me pamjen, madhështinë dhe formën e piramidës së Keopsit.
b) Autori i tekstit e di që me piramidën e Keopsit mund të spekulohet.
c) Autori i tekstit informon që me piramidën e Keopsit, nuk mund të spekulojë askush lidhur me pamjen, madhështinë dhe formën e saj.

[Shtatorja e Zeusit] Ajo ka shërbyer për shumë vjet për të kurorëzuar fituesit e olimpiadave greke.

a) Autori e krahason shtatoren e Zeusit me fituesit e olimpiadave.
b) Autori pohon se shtatorja e Zeusit ka shërbyer për një kohë të gjatë për të kurorëzuar fituesit e olimpiadave.
c) Tani që kanë kaluar shumë vjet, shtatorja e Zeusit mund të kuptohet pa fituesit e olimpiadave.

*Kur statuja [Kolosi i Rodit] përfundoi, ishte jo më pak se 32 metra e lartë.*

a) Autori informon se Kolosi i Rodit është 32 m i lartë.
b) Autori dyshon se lartësia e Kolosit të Rodit nuk dihet me saktësi.
c) Autori pohon se statuja ishte më e pakta 32 m e lartë, çka nënkupton se mund të ketë qenë edhe më e lartë se 32 m, por kurrsesi më pak.

*Tempulli i ndërtuar në nderim të saj [tempulli i Artemisës] u dogj dhe u shkatërrua gjatë një sulmi të qytetit.*

a) Autori informon se tempulli që ishte ndërtuar për të nderuar Artemisën jo vetëm u dogj, por edhe u shkatërrua.
b) Autori mendon se qyteti ku ndodhej tempulli i Artemisës u dogj dhe u shkatërrua.
c) Autori pohon se ky tempull ishte ndërtuar për të nderuar Artemisën.

*Mbreti vendosi të ndërtonte një kullë [farin e Aleksandrisë] që të identifikonte vendin dhe qytetin nga shumë larg.*

a) Autori e krahason madhështinë e mbretit me madhështinë e farit të Aleksandrisë.
b) Autori tregon se fari ka shërbyer për një kohë të gjatë si shenjë dalluese e qytetit.
c) Për shkak të një vendimi që mori mbreti, i cili synonte që qyteti të dallohej prej së largu, u ndërtua fari i Aleksandrisë.

*Kopshtet disakatëshe [Kopshtet e Varura të Babilonisë], me lartësi rreth 22 m, i përafroheshin përfytyrimit që kishin njerëzit për parajsën.*

a) Tani që Kopshtet e Varura të Babilonisë nuk ekzistojnë, njerëzit nuk mund ta gjejnë parajsën tokësore.
b) Kopshtet e Varura të Babilonisë, të ndërtuara me disa kate, me lartësi rreth 22 m, u afroheshin përfytyrimeve të njerëzve për parajsën.
c) Kopshtet e Varura të Babilonisë ishin mjaft të strukturuara dhe me mjete moderne për vaditje.

*Arkitektët e projektuan si një podium kënddrejtë mbi të cilin ngrihej një piramidë e shkallëzuar dhe në majë një statujë [Mauzoleu i Mauzolit].*

a) Projekti i arkitektëve për Mauzoleun e Mauzolit përbëhej nga një podium kënddrejtë, nga një piramidë e shkallëzuar dhe nga një statujë, të cilët vendoseshin njëri mbi tjetrin (fillimisht podiumi, mbi të piramida dhe mbi piramidën statuja).
b) Mauzoleu i Mauzolit u projektua nga arkitektët si piramidë, në majë të së cilës ndodhej një statujë.
c) Mauzoleu i Mauzolit u projektua nga arkitektët si podium kënddrejtë, në majë të të cilit ndodhej një statujë.

# Familja shqiptare dikur dhe sot

**1** **Lexoni me vëmendje fragmentin:**

*[...] femrat shqiptare janë vetëdijesuar* nëpërmjet shkollimit dhe punësimit se janë pikësëpari qenie njerëzore, pastaj femra, qenie familjare dhe shoqërore, dhe si të tilla janë pjesë aktive e familjes dhe e shoqërisë. Ato përfaqësojnë vlerat e mirëfillta të traditës që duhet të ruhen dhe të kultivohen, duke i begatuar edhe me vlera bashkëkohore, si edukimi personal dhe *ndërpersonal, bashkëpunimi, bashkëjetesa, toleranca ndërfetare dhe ndëretnike, kultura e punës, e përgjegjësisë dhe e komunikimit*.

Çfarë tregon ai në lidhje me vlerat e traditës dhe me vlerat bashkëkohore? Pse figura e femrës, si përfaqësuese e këtyre vlerave, është vendosur në qendër? Shpjegoni me fjalët tuaja ose nëpërmjet shembujve vlerat bashkëkohore të renditura nga autori.

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

# Rregullorja e bibliotekës së shkollës

**1** **Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Teksti udhëzues ka si qëllim ____________________ lexuesin hap pas hapi në lidhje me një veprimtari të caktuar. Në funksion ____________________ së shpjegimit, ai shoqërohet me ilustrime ndihmëse. Në këto lloj tekstesh përfshihen: nenet e ligjeve, ____________________, recetat e gatimit, ____________________ etj. Gjuha e përdorur në to është formale, me fjalë dhe ________________. Për të dhënë udhëzimet dhe ____________________ rreth tyre, përdoren fraza të tilla, si: së pari, ____________________, ndërkohë, ____________________, si rezultat, për rrjedhojë, ____________________, duke e krahasuar me etj.

**2** **Cili prej neneve të rregullores ju vlen më shumë? Pse?**

___________________________________________

___________________________________________

___________________________________________

**4** **Cilin prej neneve të rregullores do të donit të ndryshonit? Shkruajeni atë në formën që mendoni se do të ishte më i përshtatshëm.**

___________________________________________

___________________________________________

___________________________________________

**4** **Argumentoni pse do të ishte i nevojshëm dhe i dobishëm ndryshimi që i bëtë nenit në ushtrimin 3.**

___________________________________________

___________________________________________

___________________________________________

___________________________________________

___________________________________________

___________________________________________

___________________________________________

___________________________________________

___________________________________________

# Fjalimi i Adem Demaçit pas marrjes së çmimit "Sakharov"

**1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Teksti argumentues ka si qëllim ____________________ lexuesin për një çështje të caktuar nëpërmjet ____________________ apo arsyetimeve, të cilat janë fakte, ____________________, prova apo gjykime praktike të autorit. Autori i një teksti argumentues formulon një ____________________, e cila shfaqet e gatshme për lexuesin ose është ____________________. Çështja është një pohim, një ____________________, mbi të cilën ndërtohet i gjithë teksti. Vërtetësia e kësaj çështjeje dhe ____________________ rreth saj varen nga opinionet e autorit, ____________________ që ai sjell për ta mbështetur atë dhe për të bindur lexuesin. Llojet e teksteve argumentuese janë të shumta. Ato më të përdorshmet janë: fjalime, ____________________, artikuj gazete, ____________________, reklama promocionale etj.

Fjalimi është një ligjëratë që mbahet në një ____________________. Fjalimi mund të ketë tematika ____________________ dhe mund të jetë i organizuar në formë ____________________ apo ____________________.

**2 Gjatë parashtrimit të çështjes që e shqetëson, në fjalimin e tij të vitit 1991, Adem Demaçi shprehet:**

*E tërë Kosova është shndërruar në një megaburg, ku shqiptarët nuk gëzojnë as sigurinë më të vogël fizike, as juridike.*

Interpretoni pohimin e tij.

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

**3 Në fund të fjalimit, për ta bindur publikun mbi vërtetësinë e çështjes që ka parashtruar për zgjidhje, Demaçi përdor citimin: "Logjika e blloqeve bllokon logjikën". Jepni një shembull ku vërtetohet ai.**

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

# Biblioteka Kombëtare e Kosovës, thesar i diturisë

**1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Teksti përshkrues ka si qëllim të përshkruajë duke paraqitur ____________ tiparet e një objekti, ______________, të një kafshe, _______________ apo të një dukurie. Përshkrimi mund të jetë _______________ (në enciklopedi, ______________________, dokumente zyrtare etj.) ose _______________(në ditarët, _______________________ dhe në tekstet letrare). Përshkrimi mbështetet në _______________________: të shikuarit, _______________, të nuhaturit, ________________, të prekurit. Në të jepen detaje dhe informacione ________________ të objekteve që përshkruhen. Në tekstin përshkrues mbizotëron përdorimi ________________ dhe fjalëve përshkruese. Në funksion të përshkrimit përdoren edhe ndajfolje, ______________, fraza që tregojnë pozicionin në hapësirë të objektit që përshkruhet. Foljet e përdorura janë në kohën e tashme dhe __________________.

**2 Plotësoni tabelën.**

| Mbiemrat e përdorur për të përshkruar bibliotekën | Fjalët përshkruese të përdorura për bibliotekën |
|---|---|
| | |

**3 Bëni një përshkrim të shkurtër (objektiv ose subjektiv) të bibliotekës së shkollës suaj.**

# Theksi i fjalës

**1** **Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Çdo fjalë përbëhet nga një ose ___________ rrokje. Në fjalët me më shumë se një rrokje, dëgjohet më shumë vetëm ___________ prej tyre. Ajo quhet ____________ e theksuar. Rrokjet e tjera brenda trupit të fjalës, quhen rrokje ______________________.

Theksi i fjalës tregon rrokjen e fjalës që shqiptohet më fort. Theksin e fjalës zakonisht nuk e shkruajmë, por ____________________.

Shumica e fjalëve të gjuhës shqipe e kanë ______________ në rrokjen e parafundit. Pra, në rrokjen e dytë nga fundi i _______________.

Një numër i paktë fjalësh janë me __________ fundor. Pra, në ________________ e parë nga fundi i fjalës.

Disa fjalë të tjera të shqipes e kanë _________ në rrokjen e tretë nga fundi i fjalës. Ato quhen fjalë me theks ____________________.

**2** **Vendosni theksin në çdo fjalë:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| diellor | ndiejmë | shuall | thyerje |
| përzienim | përrua | thua | i rrëmbyeshëm |
| rini | shpatulla | trimëri | fshehurazi |

**3** **Plotësoni tabelën me fjalët e tekstit të mëposhtëm.**

*Nëpër një deriçkë të vogël hymë në një kopsht të bukur. Aty, në një kënd po rrinte një njeri me kostum pune, me duar të përvjelura. Ish ulur mbi një karrige dhe shikonte një gur të gdhendur në trajtën e njeriut. Rrinte pa lëvizur dhe vetëm nganjëherë kruante kokën pas veshit me latues të hekurt...*

*Djaloshi i Lirisë kishte shtat të hedhur dhe qëndronte në këmbë mbi një copë shkëmbi. Kokën e mbante lart me krenari të dukshme. Shikonte ëmbël nën dy vetulla të drejta. Këmbët i kishte të forta, por duart i mungonin. Në vend të tyre, ishte një copë shkëmb i pagdhendur.*

Vehbi Kikaj

| Fjalë me theks parafundor | Fjalë me theks fundor | Fjalë me theks tejfundor |
|---|---|---|
| | | |

# Intonacioni dhe theksi i fjalisë

**1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Në çdo fjali dallojmë edhe ____________________, edhe theksin e saj.

Intonacioni është forca e zërit me ulje-ngritje gjatë _________________ të fjalëve nga fillimi deri në fund ___________________.

Sipas llojit të fjalisë (dëftore, ____________, dëshirore, _____________ etj.), përcaktohet edhe __________________ i saj. Intonacionin në fjali e kemi _________________ ose zbritës.

Theksi i fjalisë zakonisht bie mbi fjalën __________________ të saj.

Përveç theksit të fjalisë, kemi edhe ____________ logjik. Këtë theks e përdorim kur duam ______________________ një nga fjalët e fjalisë.

**2 Gjeni në cilën fjalë bie theksi i fjalive të mëposhtme.**

Do të shkojmë në kinema në orën pesë. ______________________________________

Në kinema do të shkojmë në orën pesë. ______________________________________

Në orën pesë do të shkojmë në kinema. ______________________________________

**3 Tregoni me shigjetë intonacionin e fjalive të mëposhtme.**

Pyetëse: A është larg stacioni i trenit?

Dëftore: Stacioni i trenit nuk është larg.

Nxitëse: Shko te stacioni i trenit.

**4 Shkruani nga një fjali për të shprehur ndjenjat e mëposhtme. Tregoni me shigjetë intonacionin e secilës prej fjalive që shkruat.**

Gëzim:

______________________________________________________________________

Zemërim:

______________________________________________________________________

Dyshim

______________________________________________________________________

Admirim:

______________________________________________________________________

# Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme

**1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Të gjitha shkronjat që paraqesin tingujt e të folurit të gjuhës shqipe përbëjnë ________________ e saj. Gjuha shqipe ka ____ shkronja: 7 _____________ dhe 29 ________________. Bashkëtingëlloret ____________________ në **bashkëtingëllore të zëshme** (b, v, dh, d, z, x, zh, xh, gj, g, m, n, nj, j, r, rr, l, ll) dhe në **bashkëtingëllore të pazëshme** (p, f, th, t, s, c, sh, ç, q, k, h).

**2 Gjeni cila shkronjë ndryshon kuptimin e fjalëve:**

| | | |
|---|---|---|
| mal – mall _______ | orë – arë _______ | muaj – kuaj _______ |
| luaj – ruaj _______ | deri – derri _______ | hell – hedh _______ |
| dru – tru _______ | djalë – fjalë _______ | nder – ndez _______ |
| gur – mur _______ | diell – miell _______ | rresht – resht_______ |

**3 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.**

E njëri prej fëmijëve të atëhershëm rri sot para hotelit. Rri i pikëlluar pranë tavolinës dhe i kundron kalimtarët mu prej këtij vendi, ku dikur ishte hani i famshëm i Hasan Agës. I kundron njerëzit e rinj dhe pleq. I kundron me dëshirë që të njohë ndokënd. Që të gjejë pamjen e tjetrit, të heqë perden e së kaluarës... Por, pas kaq vjetësh, pas dyzet vjetëve të jetuara gjetiu, ai është tash i huaj në vendlindjen e tij.

Kurrkund nuk janë më as pemëshitësi babëlok, as teneqexhiu plak.

Po as vargu i gazmueshëm i fëmijëve. Tashmë nuk janë edhe shumë dyqane e shtëpi, shumë rrugë e rrugica.

*Hivzi Sulejmani*

Sa shkronja ka fjalia e parë e tekstit? ______________________________

Cilat janë ato? ______________________________

Sa zanore ka fjalia e dytë? ______________________________

Cilat janë ato? ______________________________

Sa bashkëtingëllore ka fjalia e tretë? ______________________________

Cilat janë ato? ______________________________

Sa shkronja të thjeshta ka fjalia e katërt? ______________________________

Cilat janë ato? ______________________________

Sa shkronja të përbëra ka fjalia e nëntë? ______________________________

Cilat janë ato? ______________________________

Sa bashkëtingëllore të zëshme ka fjalia e gjashtë? ______________________________

Cilat janë ato? ______________________________

Sa bashkëtingëllore të pazëshme ka fjalia e shtatë? ______________________________

Cilat janë ato? ______________________________

# Drejtshkrimi i lidhëzave

**1** **Nënvizoni lidhëzat e tekstit të mëposhtëm dhe plotësoni ushtrimet vijuese.**

E para: ne jemi tani njerëz të rritur, kemi punë me përgjegjësira, drejtojmë sektorë të ndryshëm të ekonomisë apo të kulturës sonë popullore dhe nuk është aspak e hijshme të merremi me gjëra që nuk janë serioze. Ju jo vetëm jetoni me kujtimet e shkuara, por s'keni sensin e kohës. Nuk është etike të më përmendni në letër, në mënyrë banale, as bostanet e mulla Elmazit, të atij njeriu anadollak që i përket të kaluarës, dhe as të shpifni në mënyrë djallëzore, se gjoja unë, kur isha i vogël, qenkam sjellë keq me mësuesit e mi dhe paskam përdorur mjete dhe metoda rrugaçësh për të ulur autoritetin e tyre, siç janë zhapinjtë, apo lloje të tjera të botës shtazore.

E dyta: llagapin "abrash" nuk dua të ma përmendni nëpër letra, përderisa ky llagap i përket të kaluarës. Ju duhet ta dini se unë kam fëmijë. Po ta marrin vesh ata këtë llagap, si do të reagojnë? A nuk do të më vini në pozita të vështira para tyre?

E treta: në qoftë se letra të tilla diskriminuese do të bien në dorë të vartësve të mi, gjë që nuk e kini marrë mirë parasysh, dua të them të punonjësve të sektorit që unë drejtoj, atëherë ç'do bëhet me autoritetin tim?

*Dritëro Agolli*

**2** **Vendosni në tabelë lidhëzat e nënvizuara.**

| Lidhëza të parme | Lidhëza të përngjitura | Shprehje lidhëzore |
|---|---|---|
| | | |

**3** **Shkruani, sipas mënyrës së formimit, dy prej lidhëzave që vendosët në tabelë.**

________________________ ________________________

**4** **Përdorni në fjali dy prej lidhëzave të parme, që vendosët në tabelë.**

________________________________________________

________________________________________________

**5** **Përdorni në fjali dy prej lidhëzave të përngjitura, që vendosët në tabelë.**

________________________________________________

________________________________________________

**6** **Përdorni në fjali dy prej shprehjeve lidhëzore, që vendosët në tabelë.**

________________________________________________

________________________________________________

# Drejtshkrimi i parafjalëve

**1** **Nënvizoni parafjalët e tekstit të mëposhtëm dhe plotësoni ushtrimet vijuese.**

Fatmirësisht, ndjesia e pakëndshme e fillimit të udhëtimit kaloi plotësisht, kështu Dardali mund të bisedonte i qetë **me** Arknerin dhe Zafirin. Të tre ishin **në** ankth të madh se ç'do të ndodhte kur të arrinin **te** vendi i trajnimeve. Orët kalonin ngadalë dhe Dardali, Arkneri dhe Zafiri, nuk kishin më se çfarë të bisedonin. Ato çaste, Dardali dalloi një fotografi të varur **në** mur, të cilën e kërkoi që çastin e parë që u fut **te** mjeti fluturues. Ishte fotografia e një ikeasi **përreth** moshës dyzetvjeçare, **me** flokë paksa të gjatë ngjyrë kafe, **me** një pamje autoritare që reflektonte forcë e guxim dhe i veshur **me** uniformën e komandantit të ushtrisë së ikeasve. **Përbri** saj, me shkronja të arta qe shkruar: "Fortjonus Askano, themeluesi dhe komandanti i ushtrisë moderne të ikeasve".

**Pranë** vendit ku ishin ulur Dardali, Arkneri dhe Zafiri gjendej një dritare e vogël. Arkneri zgjati kokën **në drejtim të** saj dhe dalloi siluetën e një ishulli, **në** një det të madh.

Fëmijët gjendeshin disa qindra metra larg koloseumit, por ai dallohej fare qartë prej madhësisë së tij. Shumica e fëmijëve e kuptuan se **rreth e qark** koloseumit duhej të gjendej ndonjë qytezë e vogël ku do të jetonin tetë vitet e ardhshme.

*Joni Boçari*

**2** **Vendosni në tabelë parafjalët e nënvizuara.**

| Parafjalë të parme | Parafjalë të përngjitura | Shprehje parafjalore |
|---|---|---|
| | | |

**3** **Shkruani, sipas mënyrës së formimit, dy prej parafjalëve që vendosët në tabelë.**

_______________ _______________

**4** **Përdorni në fjali dy prej parafjalëve të parme, që vendosët në tabelë.**

_______________

_______________

**5** **Përdorni në fjali dy prej parafjalëve të përngjitura, që vendosët në tabelë.**

_______________

_______________

**6** **Përdorni në fjali dy prej shprehjeve parafjalore, që vendosët në tabelë.**

_______________

_______________

# Fjalë të parme dhe jo të parme

**1** **Plotësoni skemën me fjalët e duhura.**



**2** **Ndani fjalët në temë dhe mbaresë.**

| | | |
|---|---|---|
| Fiku – fik - u | fjalëve ______ | qytetet ______ |
| këngët ______ | festoj ______ | bojëra ______ |
| malit ______ | fluturoj ______ | fletoren ______ |

**3** **Gjeni përbërësit e fjalëve të mëposhtme:**

| | *tema* | *rrënja* | *mbaresa* |
|---|---|---|---|
| *doreza* | | | |
| *përdorimi* | | | |
| *peshkatarët* | | | |
| *malësorin* | | | |
| *librarisë* | | | |

**4** **Lidhni prapashtesat me fjalët e dhëna, shkruani fjalët e prejardhura:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| *rrap* | *ar* ______ | *hap* | *tor* ______ |
| *mal* | *as* ______ | *besnik* | *o* ______ |
| *det* | *(ë) im* ______ | *ulli* | *(i) shte* ______ |
| *punë* | *(i)shte* ______ | *festë* | *(ë) ri* ______ |
| *majtë* | *(ë) si* ______ | *punë* | *je* ______ |

**5** **Lidhni fjalën e parme me fjalën e prejardhur prej saj**

| | | | |
|---|---|---|---|
| *punë* | *lexim* | *ditë* | *fjalor* |
| *shkollë* | *përflas* | *akull* | *librari* |
| *lexoj* | *shkollor* | *orë* | *ditar* |
| *hekur* | *punëtor* | *libër* | *orar* |
| *flas* | *hekuros* | *fjalë* | *akullore* |

**6** **Krijoni fjalë të prejardhura me prapashtesat:**

| | | |
|---|---|---|
| ______ - ak | ______ - or | ______ - tar |
| ______ - ak | ______ - or | ______ - tar |
| ______ - ak | ______ - or | ______ - tar |

**7** **Ktheni fjalët *det* dhe *flutur* në fjalë të prejardhura dhe krijoni nga një fjali me to.**

______

______

______

______

______

______

# Fjala dhe kuptimi i saj

**1** **Fjalët *sy, kokë, ballë* dhe *botë* janë përdorur me kuptim të drejtpërdrejtë dhe me kuptim të figurshëm. Dalloni fjalinë, ku secila prej fjalëve është përdorur me kuptim të drejtpërdrejtë. Shpjegoni fjalitë në të cilat fjalët janë përdorur në kuptim të figurshëm.**

E ka halë në sy.

______________________________________________

E pashë me këta sy.

______________________________________________

Mos t'i pafsha sytë.

______________________________________________

Ma bëri me kokë.

______________________________________________

S'e çan kokën.

______________________________________________

Tundi kokën.

______________________________________________

Ka ballë të vogël.

______________________________________________

Doli me ballin lart.

______________________________________________

E vuri në ballë të shtëpisë.

______________________________________________

Ka një botë me ëndrra.

______________________________________________

Lëviz nëpër botë.

______________________________________________

Jeton në botën e çudirave.

______________________________________________

**2** **Gjeni kuptime të figurshme për fjalët e mëposhtme.**

Këmbë ____________ ____________ ____________

Gojë ____________ ____________ ____________

Dorë ____________ ____________ ____________

Gisht ____________ ____________ ____________

**3** **Krijoni fjali në të cilat t'i përdorni shprehjet e mëposhtme në kuptimet e dhëna.**

*E la në bisht – i doli përpara, ia kaloi, e la prapa.*

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

*Bën bisht – shmanget, bën mënjanë ose largohet.*

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

*I mban bishtin – e përkrah dikë e i bën qejfin, vepron si ai ose bën si thotë ai.*

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

*Thelë mbi bisht – diçka e tepërt, më shumë nga ç'duhet.*

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

# Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj

**1** **Shkruani në gjuhën standarde fragmentin e mëposhtëm.**

U bë një zhurmë e madhe, ndërsa po merreshin vesh ndër vete se çka do të ndiqte secili prej tyre. Më në fund, çdo gjë u zgjidh. U ndërruan rolet dhe veglat e lojës. Vargu i hasharinjve rishtas vrapon. Me hov e potere. Me sy të ngulur në veglat e tyre, sikur të donin t'ua cikin tërë ëmbëlsinë e lojës.

Kur pak më vonë u gjetën pranë dyqanit të pemëshitësit Ymer, papritmas fryu një erë e furishme. Malli i tij, i rregulluar për bukuri, përpara dugajës së vogël, fluturoi rrugës teposhtë... Shportat e vjetra, arkat e luhatshme dhe teneqetë e ndryshkura, bënë të qeshë bota me rrokullisjet e tyre buçitëse.

– Të vraftë Zoti që të bëri! – e mallkoi erën pemëshitësi bablok, duke shikuar mallin e vet të mjerë nëpër kalldrëmin e çarshisë.

Ndërsa ai shtrëngonte dëshpërueshëm grushtet nga e keqja që e gjet dhe pa mundur të bëjë gjë, fëmijët e muarën situatën në dorë.

*Hivzi Sulejmani*

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

___

# Klasat e fjalëve




**1** **Emërtoni pjesët e ligjëratës:**

1. Ndajfolje ____________________
2. ____________________
3. ____________________
4. ____________________
5. ____________________

**2** **Lakoni fjalët në tabelë:**

| Pjesa e ligjëratës | Fjala | Emërore | Gjinore | Dhanore | Kallëzore | Rrjedhore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Emri | det | | | | | |
| Mbiemri | i zi | | | | | |
| Përemri | ne | | | | | |
| Numërori | i dhjetë | | | | | |

**3** **Vendosni në tabelë fjalët e ndryshueshme që janë në tekst.**

*Lart në male ishte ende pranverë. Shkrinte akulli dhe dëbora , buçisnin rrëketë dhe përrenjtë, gurgullonin krojet. Harlisej bari i ri shumë i hollë, bleronin drurët e shkurret. Dukej sikur fryma e jetës lundronte në ajër...*

| Emra | Mbiemra | Përemra | Numëror | Folje |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

**4** **Cilës klasë i përkasin fjalët e nënvizuara? Ç’funksion kryejnë në fjali?**

- Ju të bukur zogj, te ju kam shumë shpresë. ____________ ____________
- Erdhi dimri i keq, një mëngjes të zi. ____________ ____________
- Në ëndërr ç’e pa, gjarprin në pyll. ____________ ____________
- Shkoi dhe i hodhi vajzës një kurorë. ____________ ____________

# Emri

**1** **Në tabelën e dhënë, qarkoni dhjetë emra.**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | I | R | A | N | A | F | L | U | T | U | R | A |
| A | R | A | T | M | A | L | I | P | E | M | E | T |
| D | U | R | R | E | S | D | H | E | L | P | Ë | R |
| V | A | L | B | O | N | A | P | A | T | A | T | E |
| D | O | M | A | T | E | B | E | S | N | I | K | U |
| L | U | M | I | Z | O | G | U | D | A | J | T | I |

**2** **Formoni fjali me katër nga emrat e përveçëm të tabelës.**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**3** **Plotësoni paragrafin me emrat që mungojnë. (Shqipëri, lidhjet me, në Arbëri, papën, familja, shek. XIII)**

Nga fundi i ____________ vendin e familjes Skurra ____________ e zuri ____________ fisnike e Topiajve. Ajo shfrytëzoi ____________ Napolin dhe ____________ e Romës, për të zgjeruar zotërimet e saj në ____________ e Mesme.

**4** **Shkruani emrat:**

e dy skuadrave të futbollit ____________

të tri llojeve të makinave ____________

të tri këngëtareve ____________

të dy shkollave 9-vjeçare ____________

**5** **Cili emër është futur gabim? Pse?**

nxënës, mësues, shoqe, pema, gjallëria, libri ____________

lartësi, dituria, dobësia, pasuria, farmacia, dhimbja ____________

lumi, fusha, mali, kodra, Dajti, rruga, deti, liqeni ____________

**6** **Shkruani emra abstraktë që vijnë nga fjalët e dhëna:**

gëzoj – gëzim

i bukur ____________

shëtis ____________

i lig ____________

i mirë ____________

fatkeq ____________

i ngadaltë ____________

# Gjinia dhe numri i emrit

**1** **Shkruani gjininë mashkullore të emrave:**

| Emrat | Gjinia mashkullore |
|---|---|
| motër | vëlla |
| vajzë | |
| mbesë | |
| grua | |

| Emrat | Gjinia mashkullore |
|---|---|
| pulë | gjel |
| femra | |
| nusja | |
| kunatë | |

**2** **Shkruani numrin shumës të emrave:**

(një) varg - (ca) ______________________
(një) pyll - (ca)______________________
(një) breg - (ca)______________________
(një) përrua - (ca) ______________________
(një) shteg - (ca)______________________
(një) lëng - (ca) ______________________

**3** **Nënvizoni emrat në tekst dhe plotësoni me ta tabelën e mëposhtme.**

**Fshatarët** e vunë **bustin** në **mushkë**. **Nurk**a... ecte krah **Rustemit**. Pasi lanë **qafën** e **kodrës** dhe **plepat**, i ranë përmes një **arre** të korrur... **Dielli** kishte hyrë në **mal** dhe atje, në **majë** të **kodrës**, skuqte **perëndimi**.

**Mushka** ecte mes **arës** me **duaj** dhe **busti** skuqte nga **perëndimi**. **Rustemi** dhe **Nurka**, tek-tuk, shkëmbenin ndonjë **fjalë**.

*Dritëro Agolli*

| *Emri* | *Numri* | | *Lloji* | | | *Gjinia* | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Njëjës* | *Shumës* | *I përveçëm* | *I përgjithshëm* | | *Mashkullore* | *Femërore* |
| | | | | *Konkret* | *Abstrakt* | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

# Lakimi i emrave

**1** **Lakoni emrat e dhënë në tabelë.**

| Emërore | Gëzimi | shkolla | rrugë | Anëtarë |
|---|---|---|---|---|
| Gjinore | | | | |
| Dhanore | | | | |
| Kallëzore | | | | |
| Rrjedhore | | | | |

**2** **Vendosni në kolonën e duhur emrat:** *astrolog, tokë, syri, trishtimin, botë, koha, jeta, mënyrat, ditësh, lakmia, lumturi, lagështirë, qëllimin, fatin.*

| Emra në trajtë të shquar | Emra në trajtë të pashquar |
|---|---|
| | |

**3** **Emrat e tabelës së ushtrimit 2 kthejini nga trajta e shquar në të pashquar dhe anasjellas.**

______________________ ______________________

______________________ ______________________

______________________ ______________________

______________________ ______________________

______________________ ______________________

______________________ ______________________

______________________ ______________________

**4** **Përgjigjuni pyetjeve sipas shembullit të dhënë. Nënvizoni emrin dhe përcaktoni rasën e tij.**

Kush është futbollisti që të pëlqen më shumë?

*Futbollisti që më pëlqen më shumë, është Lionel Mesi.* *Rasa emërore*

Bluzën e kujt futbollisti ke veshur?

______________________ __________

Kujt futbollisti do t'i kërkoje autograf?

______________________ __________

Kë futbollist do të ftoje në shkollë?

______________________ __________

Prej kujt futbollisti e ke mësuar këtë gjuajtje?

______________________ __________

# Përshtatja e mbiemrit me emrin

**1 Vendosni mbiemrat sipas llojit të tyre.**

Ndërtesa e bukur dykatëshe e shkollës për fëmijët e lagjes së re të qytetit, po mbaron. Muret e larta rrethuese shkëlqejnë nga ngjyrat e shumëllojshme dhe pikturat interesante, të bëra nga dora e fëmijëve të vegjël.

*Të nyjshëm*



*Të panyjshëm*



**2 Shkruani në shumës grupet e fjalëve:**

lajm i rrallë ______________________ fshat i largët ______________________

lëng tretës ______________________ ujë i ftohtë ______________________

det i thellë ______________________ shi i rrëmbyeshëm ______________________

(Kujdes: Emrat e mësipërm të gjinisë dalin në shumës me -**e** ose -**ra**.)

**3 Lakoni mbiemrat e shoqëruar me emra:**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Emërore | nxënëse e zgjuar | | fëmijë i shkathët | |
| Gjinore | | | | |
| Dhanore | | | | kohës së mirë |
| Kallëzore | | fjalën e pathënë | | |
| Rrjedhore | | | | |

**4 Përshtatni mbiemrin me emrin përkatës, formoni fjali me çdo grup:**

(i rrumbullakët) një tryezë ______________________

(elektronik) aparate ______________________

(i sivjetshëm) drithëra ______________________

(i shpejtë) ritme ______________________

(ujitëse) kanale ______________________

(i drejtë) mendime ______________________

(nëntokësor) ujëra ______________________

**5 Shkruani fjali duke i përdorur mbiemrat në shkallën që kërkohet:**

Pohore: e lulëzuar – fushat ______________________

Krahasore: i gëzuar – shokët ______________________

Sipërore: i shpejtë – lumenjtë ______________________

**6 Zëvendësoni shprehjet e mëposhtme me mbiemra në shkallën sipërore.**

Ai fle me sy hapur. ______________________

Nuk shkel në dërrasë të kalbur. ______________________

Është bërë kockë e lëkurë. ______________________

# Përemrat

**1 Lidhni me shigjetë përemrat me llojet e tyre.**

| | |
|---|---|
| **dëftorë** | unë, ti, ai/ajo, ne, ju ata/ato |
| **lidhorë** | vetja, vetvetja |
| **vetorë** | ky, kjo, ai/ajo, i/e tillë, i/e këtillë |
| **pyetës** | im, i saj, jote, i tyre, juaj |
| **të pacaktuar** | kush? cili? cila? cilët? cilat? |
| **vetvetorë** | që, i cili, e cila, të cilët, të cilat |
| **pronorë** | çdo, dikush, askush, secili, ndonjëri |

**2 Gjeni përemrat dhe vendosini në tabelë.**

*Kush jeton afër maleve, e di mirë se në çdo stinë ato ndryshojnë pamjen, por historia që do t'ju tregoj është për Malin e Murrmë, i cili nuk ndryshonte kurrë.*

*Edhe kjo pranverë kështu e gjeti Malin e Murrmë. Dielli përshëndeti të gjitha malet përreth, por rrezet e tij të ngrohta nuk depërtonin në Malin e Murrmë. Ç'kish ndodhur vallë? Pse gjithë ky trishtim? Dikur edhe ai ishte si gjithë të tjerët.*

| Vetor | Dëftor | Pronor | Lidhor | Pyetës | I pacaktuar | Vetvetor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

**3 Formoni nga një fjali për çdo lloj përemri.**

Vetor ______________________________
Vetvetor ____________________________
Dëftor ______________________________
Pronor ______________________________

Lidhor ______________________________
Pyetës ______________________________
I pacaktuar __________________________

**4 Vendosni përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra që mungojnë.**

– Ku do të shkojmë, imzot? – pyeti ________.
– ______________ ço tek ai djali që lyen këpucët.
– Eja, – tha. Lër ________ të gjitha aty. Nuk do të të duhen as furçat, as bojërat.
– Pse nuk ke ardhur të ________ takosh tërë këtë kohë?
– Mora vesh se ________ u bëre... dhe...
– Ah, edhe ________, miku im i vjetër, po ________ flet kështu?!

**5 Lakoni përemrat në tabelë.**

| **Emërore** | ajo | vetja | kjo | kush | i cili | secili | dikush |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Gjinore** | | | | | | | |
| **Dhanore** | | | | | | | |
| **Kallëzore** | | | | | | | |
| **Rrjedhore** | | | | | | | |

**6** **Lakoni përemrat vetorë në tabelë:**

| Rasat | Pyetjet | Unë | Ti | Ai /ajo | Ne | Ju | Ata /ato |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emërore | kush? | | | | | | |
| Gjinore | i, e kujt? | | | i, e atij | | | |
| Dhanore | kujt? | mua më | | | neve na | | |
| Kallëzore | kë? | | | | | ju ju | |
| Rrjedhore | prej kujt? | | prej teje | | | | |

**7** **Vendosni në petalet e luleve trajtat e shkurtra sipas tabelës.**

*Rasa dhanore*



*kujt?*

*Rasa kallëzore*



*kë?*

**8** **Gjeni në tekstin e mëposhtëm trajtat e shkurtra.**

M'i sillni të tre këtu. Do t'ua dërgoj prindërve, që edhe ata ta mësojnë të vërtetën, t'i njohin më mirë fëmijët e tyre. Njëri nga djemtë guxoi e tha:

– A mund t'ju sqaroj diçka?

– Thuaj ç'të duash, po unë ta njoh tipin ty, t'i di të gjitha ç'ke bërë.

– Na lini edhe ditën e sotme, që çdo gjë ta vëmë në vend, – iu lut edhe djali tjetër.

– Mos m'u lutni fare. Ju kam tërhequr vëmendjen edhe herë të tjera.

**9** **Lidhni me shigjetë:**

| | |
|---|---|
| *Emërore* | *atyre, u* |
| *Gjinore* | *prej nesh* |
| *Dhanore* | *atë, e* |
| *Kallëzore* | *i (e) asaj* |
| *Rrjedhore* | *ju* |

| | |
|---|---|
| *Emërore* | *mua, më* |
| *Gjinore* | *prej meje* |
| *Dhanore* | *atyre* |
| *Kallëzore* | *ju ju* |
| *Rrjedhore* | *ato* |

| | |
|---|---|
| *Emërore* | *atë, e* |
| *Gjinore* | *prej meje* |
| *Dhanore* | *ai* |
| *Kallëzore* | *i atij* |
| *Rrjedhore* | *asaj* |

**10** **Gjeni dhe rrumbullakosni trajtat e shkurtra në tekstin e mëposhtëm.**

Gjyshja na tregoi për babin kur ishte i vogël. Mami dhe babi më përqafonin dhe më thoshin se u dukej çudi që vajza e tyre ishte rritur aq shpejt. Prindërit më dhuruan librin "Sirena e vogël", të cilin unë e pëlqej shumë.

# Folja

**1** **Nënvizoni foljet në tekst dhe plotësoni me ta tabelën e mëposhtme.**

Një fshatar kishte një dele, të cilën donte ta shiste. U nis që herët për në qytet. Udha ishte e gjatë. Ndaloi pranë një burimi për të pushuar dhe më pas vazhdoi rrugën. Qyteti ishte i zhurmshëm dhe në pazarin e kafshëve kishte edhe fshatarë të tjerë që, si ai, kishin nxjerrë delet e tyre për shitje. Ndenji gjatë në pazar, prandaj u mërzit shumë. Kërkoi me sy ndonjë të njohur, por nuk pa asnjë. "Ikim, – i foli deles, – nuk do të ikësh nga shtëpia. Rri e kënaqu me kalamajtë."

| Folje që tregojnë veprim | Folje që tregojnë gjendje |
| --- | --- |
| | |

**2** **Shkruaj foljen e duhur, duke e përshtatur me kryefjalën e fjalisë.**

Arbana i ____________________ një ninullë motrës së vogël.
Përpara postës ____________________ shumë njerëz në radhë.
Kushërinjtë e mi dje ____________________ një ekskursion mësimor.
Ju ____________________ vendimin e duhur.
Erblini ____________________ edhe herë të tjera këtu.

**3** **Formoni fjali në të cilat të përdorni foljet e mëposhtme. Përbri shkruani se cilit zgjedhim i përkasin.**

Do të pikturoj - Zgjedhimi i parë

________________________________________________________________________________

Kapte - ____________________________________

________________________________________________________________________________

Këndonte - ____________________________________

________________________________________________________________________________

Hanim - ____________________________________

________________________________________________________________________________

Flisni - ____________________________________

________________________________________________________________________________

# Mënyrat dhe kohët e foljes

**1** **Vendosni në tabelë foljet:** *do të rrija, të ecja, punonte, kishte marrë, mëso, paske ardhur, rrofsh, të vij, do të vija, vizato, të kenë dhënë, hapte, vizatuaka, këndofshi, do të kisha fituar, do të pikturoj.*

| Mënyra dëftore | Mënyra lidhore | Mënyra kushtore | Mënyra habitore | Mënyra dëshirore | Mënyra urdhërore |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |

**2** **Vendosni foljet në kllapa në formën e duhur. Përcaktoni se në cilën mënyrë janë.**

Po (stërvit) ____________________ më shumë, do të kishe fituar garën.
Në klasën tonë ai (jam) ____________________ më i miri në matematikë.
Kur (vij) ____________________ ti, unë do t'i kem mbaruar mësimet.
(Vij) ____________________ me ty, po të kisha pushim.
(Fle) ____________________ se pushim e ke nesër.
Nuk mund (rri) ____________________ pa filluar nga puna.

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

**3** **Vendosni në të gjitha mënyrat foljet e dhëna në tabelë.**

| Mënyra dëftore | Mënyra lidhore | Mënyra kushtore | Mënyra habitore | Mënyra dëshirore | Mënyra urdhërore |
|---|---|---|---|---|---|
| Dal | | | | | |
| Kërkoj | | | | | |
| Zbraz | | | | | |
| Mbush | | | | | |
| Mësoj | | | | | |
| fshij | | | | | |
| Di | | | | | |
| Luaj | | | | | |
| Shëtit | | | | | |
| Pi | | | | | |
| Hap | | | | | |

# Zgjedhimi i foljeve në formën veprore të mënyrës dëftore

**1** **Gjeni foljet dhe vendosini në tabelë sipas mënyrave.**

1. Era është me zemër dhe mendje të hapur. 2. U trashëgofshi! 3. Qofshi faqebardhë! 4. Folka bukur kjo vajzë! 5. Të dalim të gjithë e t'i presim krahëhapur. 6. Po të mësonte pak më tepër, do ta kalonte klasën e shtatë. 7. Hapma derën, se nuk kam çelës. 8. Të thashë që kjo punë nuk mbaron shpejt.

| Dëftore | Lidhore | Habitore | Dëshirore | Kushtore | Urdhërore |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

**2** **Plotësoni tabelën me kohët e thjeshta të mënyrës dëftore, ndani mbaresat.**

| | E tashme | E pakryer | E kryer e thjeshtë | E ardhme | | E tashme | E pakryer | E kryer e thjeshtë | E ardhme |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Unë | | | | do të mëso-j | Ne | | mëso-nim | | |
| Ti | mëso-n | | | | Ju | | | | |
| Ai/ajo | | | | | Ata/ato | | | | |

**3** **Ktheni foljet nga koha e pakryer, në të kryerën e thjeshtë.**

Ne lexonim në bibliotekën e shkollës. ____________________

Sportdashësit prisnin fillimin e lojës. ____________________

Notari vishte pajisjet e zhytjes. ____________________

Nxënësit po bisedonin me njëri-tjetrin. ____________________

**4** **Lidhni foljet me kohët përkatëse.**

| | |
|---|---|
| *mësonte* → | *më se e kryer* |
| *hapa* | *e pakryer* |
| *do të kemi larë* | *e kryer e thjeshtë* |
| *pikturoi* | *e ardhme e përparme* |
| *do të mësojë* | *e ardhme* |
| *kisha fjetur* | *e kryer* |

**5** **Shkruani kohët e përbëra të foljeve:** *dëfrej, shes, shikoj, di, mbjell.*

| E kryer | Më se e kryer | E kryer e tejshkuar | E ardhme e përparme |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

# Zgjedhimi i foljeve në formën veprore të mënyrës lidhore

**1** **Gjeni foljet e mënyrës lidhore dhe vendosini në tabelë.**

1. Është detyra jote të dëgjosh mësimin me vëmendje. 2. Po të jeni dakord që të vijmë edhe ne me ju, ne jemi gati. 3. Sikur të na kishit njoftuar më parë! 4. Mendoj se ai të ka thënë të vërtetën. 5. E prisja të dëgjoja mendimin tënd.

| E tashme | E pakryer | E kryer | Më se e kryer |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**2** **Rishkruani fjalitë që ta tregojnë veprimin si të mundshëm:**

- Sonja nuk e ktheu kokën nga i sëmuri. ____________________
- Që aty shikonim dallgët e shkumën borë të bardhë. ____________________
- Mira do të vijë në shkollë në orën e caktuar. ____________________
- Do të shkoj patjetër te dentisti. ____________________

**3** **Përshtatini foljet në mënyrën lidhore sipas shembullit:**

Duhet që ti të vish me ne.
Duhej që ti të vije me ne.

a) Është koha që secili të marrë përgjegjësitë e veta.
Ishte koha ____________________

b) Mendon që Adi të jetë kthyer?
Mendoje që ____________________

c) Mezi po pres të fillojë shfaqja.
Mezi po priste ____________________

**4** **Ktheni foljet e mëposhtme në mënyrën lidhore.**

ai merr ____________ ti del ____________
ti rri ____________ ti vë ____________
ju rrinit ____________ ti pret ____________

**5** **Zgjidhni formën kohore që i përshtatet fjalisë dhe plotësoni ushtrimin.** (2 pikë)

Ndërsa fliste, dora e tij __________ meshinin e çantës, sikur ai meshin __________ të dhënat që i duheshin.

a) vazhdoi të fërkonte - do të nisë
b) vazhdonte të fërkonte - do t'i niste
c) vazhdoi të fërkojë - të nisë
d) vazhdonte të fërkonte - do të niste

# Zgjedhimi i foljeve në formën joveprore të mënyrës dëftore dhe lidhore

**1** **Gjeni foljet dhe renditini në tabelë.**

*Nga thellësia e tunelit u lëshua një shigjetë e hollë dhe e gjatë. Ajo çau mespërmes rrethin dhe ciku dorën e Ninës, që s'iu drodh qerpiku. Nga smeraldi i unazës doli një fjollë tymi, që e mbështolli tërë masën e shkëmbit dhe u dëgjua një melodi kambanash, harpash dhe violinash, që s'dihej nga vinte.*

| Foljet | Veta I njëjës | Zgjedhim I | Zgjedhim II | Zgjedhim III |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

**2** **Gjeni temën dhe mbaresën te foljet: punonin, mësoja, hapte, pinte.**

Tema

____________________

____________________

____________________

Mbaresa

____________________

____________________

____________________

**3** **Nënvizoni foljet dhe vendosini në tabelë sipas kërkesave:**

Paniku mbretëronte në tërë Shqipërinë. Tmerri i bënte njerëzit të shikonin kuçedra dhe fantazma me sy hapur. Makthi u kishte shkelur të gjithëve në grykë e në kraharor. Me sy të vrarë e të përlotur putheshin njëri me tjetrin, duke qarë dhe duke vajtuar sikur takoheshin për herë të fundit.

| Folja | Mënyra | Veta | Koha | Numri | Zgjedhimi |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

**4** **Plotësoni foljet sipas kohëve në tabelë:**

| Kohët e thjeshta | | | |
|---|---|---|---|
| E tashme | E pakryer | E kryer e thjeshtë | E ardhme |
| shikoj | | | |
| mbjell | | | |
| vë | | | |

| Kohët e përbëra | | | |
|---|---|---|---|
| E kryer | Më se e kryer | E kryer e tejshkuar | E ardhme e përparme |
| kam parë | | | |
| kam mbjellë | | | |
| kam vënë | | | |

**5** **Vendosni foljet sipas mënyrave:**

| Dëftore | Lidhore | Habitore | Dëshirore | Kushtore | Urdhërore |
|---|---|---|---|---|---|
| mendoj | | | | | |
| kap | | | | | |
| fle | | | | | |

i / Punohet pas faqes 201

# Ndajfolja

**1 Gjeni ndajfoljet dhe vendosini në tabelë sipas llojit.**

1. Ajo vishet vërtet shumë bukur. 2. Herë tjetër duhet të mendohemi më mirë për veprimtarinë. 3. Ajo fliste krejt si e ëma. 4. Dritat e një makine zbardhën papritur një pjesë të rrugës. 5. Pikat e shiut godisnin herë pas here xhamin e makinës. 6. Tani ajo punon tetë orë në ditë. 7. Ngado shikoje grupe njerëzish të gëzuar. 8. Do të të shoqëroj deri atje, pastaj vazhdo djathtas.

| Vendi (Ku?) | Kohe (Kur?) | Sasie (Sa?) | Mënyre (Si?) | Shkaku (Pse?) |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

**2 Vendosni nga gjashtë ndajfolje pranë foljeve.**







**3 Përdorni në fjali ndajfoljet e mëposhtme:**

- shpejt e shpejt ______
- rrallë ______
- jashtë ______
- asnjëherë ______
- hap pas hapi ______

**4 Përdorni në fjali ndajfoljet në tri shkallë të tyre:**

*mirë* → *pohore* ______
→ *krahasore* ______
→ *sipërore* ______

*shpejt* → *pohore* ______
→ *krahasore* ______
→ *sipërore* ______

*lehtë* → *pohore* ______
→ *krahasore* ______
→ *sipërore* ______

# Lidhëzat

## 1 Lidhni lidhëzat me llojet e tyre:

| Llojet e lidhëzave bashkërenditëse | Lidhëzat |
|---|---|
| shtuese | kurse, megjithatë, megjithëkëtë, mirëpo, ndërsa, teksa, po(r), porse, veç, veçse, vetëm, vetëm se etj. |
| veçuese | andaj, ndaj, pa, pra, prandaj, domethënë etj. |
| kundërshtuese | as, dhe, e, edhe, si (e) dhe, hem...hem, si...si, si... ashtu ... (e) dhe etj. |
| përmbyllëse | a, apo, o, ose, daç... daç, ja... ja, ndo... ndo, qoftë... qoftë etj. |

| Llojet e lidhëzave nënrenditëse | Lidhëzat |
|---|---|
| **Lidhëza shkakore** | që, se. |
| **Lidhëza kushtore** | ku, tek, nga, kudo, ngado, deri ku, nga ku, kudo që, ngado që etj. |
| **Lidhëza rrjedhimore** | kur, sa, tek, derisa, pasi, porsa, teksa, sapo që, që kur, qysh se etj |
| **Lidhëza ftilluese** | se, sepse, gjersa, meqenëse, meqë, ngaqë, për arsye se, për shkak se etj. |
| **Lidhëza qëllimore** | që, me qëllim që, në mënyrë që. |
| **Lidhëza mënyrore** | sa që, kështu që |
| **Lidhëza vendore** | në, po, nëse, kur, sikur, në qoftë se, në rast se, po qe se etj. |
| **Lidhëza kohore** | sa, se, si, sesa, po(r) si, sikurse, ashtu si(ç) etj. |

## 2 Gjeni lidhëzat dhe shkruajini më poshtë:




______________________________________________

______________________________________________

## 3 Vendosni lidhëzat aty ku mungojnë (e, sikur, dhe, por, sepse, dhe)

– Ah, more djalë__________ të më dëgjoje këshillat! – tha gjyshja. – Do të vijë një ditë __________ do t'i kujtosh fjalët e mia, __________ do të jetë vonë.

– Nëno, unë të dua shumë __________ do të të respektoj, __________ këshillat e tua janë të vlefshme __________ unë do t'i zbatoj gjithmonë ato.

## 4 Plotësoni fjalitë e mëposhtme, nënvizoni lidhëzat, tregoni llojin e tyre.

– Eni shkoi dhe __________

– Eni shkoi, por__________

– Eni nuk shkoi, prandaj __________

– Eni nuk shkoi, kurse __________

## 5 Formoni fjali me lidhëzat e mëposhtme:

por __________

edhe __________

kurse __________

sepse __________

ose __________

kur __________

# Parafjala

**1 Vendosni parafjalët në vendet bosh:**

Ai më shkruante:

"Lutju nënës sate që të më falë ____________ qëndrimin tim. Dorën e saj e kam gjithmonë ____________supe dhe shpesh herë mbushem ____________ lot. Që atëherë desha ta puthja dhe ta lusja që të më falte, por nuk kisha as forcë, as guxim për ta bërë këtë. ____________ mua, buka asnjëherë nuk ka qenë aq e ëmbël, aq e butë dhe aq e shijshme sa atëherë kur e merrja ____________ dorës së saj.

Të lutem, puthe____________ unë atë dorë të mirë, të ngrohtë!"

**2 Plotësoni petalet e luleve me parafjalë sipas rasave:**

Rasa ____________

Rasa ____________

Rasa ____________



**3 Formoni fjali me pesë nga parafjalët e mësipërme.**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**4 Nëvizoni me një vizë parafjalët dhe me dy viza ndajfoljet:**

- Mos më rri pranë.
- Ai më doli përpara.
- Ti më dole kundër.
- Mos rri pranë zjarrit.
- Ai doli përpara meje.
- Ai foli kundër mendimeve të mia.

- Afër shkollës është palestra.
- Vendosi librat sipër tavolinës.
- Pas teje do të futem edhe unë.
- Ishim larg parashikimit të fitores.
- Fëmijës i qëndro gjithmonë afër.
- Ngjitu sipër.
- Mos i qëndro atij nga pas.
- Dëgjohej zëri shumë larg.

**5 Shkruani parafjalët e ushtrimit pesë, thoni rasën e tyre.**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

# Teksti, paragrafi, fjalia, gjymtyra

**1 Përcaktoni sa paragrafë dhe sa fjali ka teksti i mëposhtëm.**

*Sapo mbaroi së eksperimentuari forcën e rëndesës, Mika u ul këmbadoras për të provuar barin. E nuhati, shkuli një tufë fijesh e i futi në gojë.*
*Nuk duhet të kishin ndonjë shije të mirë, sepse i pështyu pothuajse menjëherë. U kollit disa herë e pështyu përsëri, i vinte pothuajse neveri.*
*Mika ishte nisur nga një planet tjetër dhe kishte përballuar një udhëtim prej disa muajsh, sigurisht duhet të ishte i uritur...*
*U turra vrap drejt një peme dhe mora nga toka një mollë të shijshme.*

Paragrafë: ______________________ Fjali ______________________

**2 Lidhni fjalët dhe shkruani fjalinë më të shkurtër. Zgjeroni grupin e emrit (kryefjalën) dhe grupin e foljes (kallëzuesin).**

| Lidhni kryefjalën me kallëzuesin | | Fjalia më e shkurtër | Fjalia e zgjeruar |
|---|---|---|---|
| Pallati | u blenë | | |
| Rruga | çelën | | |
| Deti | u ndërtua | | |
| Lulet | ka dallgë | Lulet çelën. | |
| Librat | kalohet | | |

**3 Zvogëloni, sa më shumë të jetë e mundur, fjalinë: *"Kënga e zogjve të pranverës së sapoardhur dëgjohej deri tej në fund të luginës së Valbonës"* .**

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

**4 Zgjeroni GE me një përcaktor, dhe GF me një rrethanor kohe dhe një vendi.**

Gjiganti nuk u ngrit.

Gjiganti __________ nuk u ngrit ______________________

**5 Zgjeroni grupin emëror të kryefjalës me një ose më shumë fjalë.**

Dyqani ______________________ u mbyll për shumë ditë.
Prindërit ______________________ pritën gjatë një telefon.
Motra ______________________ bëri shumë prova para se të dilte para shokëve të saj

# Fjalia foljore dhe fjalia jofoljore

**1** **Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.**

Fjalia foljore ndërtohet rreth një ____________________, të cilin zakonisht e shoqëron edhe një grup emëror.

Fjalia jofoljore përmban një ose disa ____________, por asnjëra prej tyre nuk është ___________.

**2** **Plotësoni dialogun me fjali jofoljore.**

– Si kalove sot në shkollë?

________________________________________________________________

– More ndonjë notë?

________________________________________________________________

– Çfarë note?

________________________________________________________________

– Në cilën lëndë?

________________________________________________________________

**3** **Nënvizoni me një vijë fjalitë foljore dhe me dy vija fjalitë jofoljore. Shkruani grupin foljor të secilës prej fjalive foljore.**

Edipi, tek po udhëtonte për në Tebë, kaloi nga mali Fokios, ku sundonte Sfinksi. Përbindëshi e ndali dhe e ftoi të zgjidhte enigmën. Dhe ja se ç'pyetje i bëri:

– Cila është ajo krijesë që, në mëngjes shkon me të katra, në mesditë me të dyja e në mbrëmje me të tria, e sa më shumë këmbë të ketë, aq më me shumë vështirësi ecën?

Edipi iu përgjigj në çast:

– Njeriu! Dhe ja përse. Kur është foshnjë, ecën me këmbë e duar, do të thotë me të katra; tek rritet, ecën vetëm me dy këmbë e tij; dhe, kur plaket, mban edhe shkop.

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

________________________________________________________________

# Fjalia dëftore dhe fjalia pyetëse

**1** **Për secilën nga fjalitë e mëposhtme dëftore, shkruani nga një fjali pyetëse dhe anasjellas.**

Aty kaluan tri volejbolliste të skuadrës së qytetit.

_______________________________________________

Motori i makinës ulërin nga rruga malore.

_______________________________________________

A ndodhet aty edhe Besmiri?

_______________________________________________

Erdhi edhe Besa bashkë me ju?

_______________________________________________

Ne gjetëm një zgjidhje të përshtatshme për situatën e krijuar.

_______________________________________________

**2** **Shkruani fjali pyetëse duke përdorur fjalët pyetëse:**

Kush _______________________________________________

Pse _______________________________________________

Me çfarë _______________________________________________

A mendoni se _______________________________________________

**3** **Shkruaj P përbri fjalive pyetëse të pjesshme dhe T përbri fjalive pyetëse tërësore.**

Cila nga vajzat e fitoi konkursin? __________

Kë mori me vete babai në mal për garat me ski? __________

Erdhën të gjithë, vallë? __________

Thua të mos jenë njoftuar në kohë? __________

Si dukej ajo vajzë në stërvitje? __________

A do të shkojmë? __________

Kujt ia dhurove atë libër? __________

Kur do të nisemi për në Krujë? __________

Me çfarë e pikturove atë portret? __________

# Fjalia dëshirore dhe fjalia nxitëse

**1 Lexoni fjalitë dëshirore dhe përgjigjuni pyetjeve vijuese.**

Dalsh faqebardhë në provime!
Ah, sikur ta fitoja unë këtë garë të vështirë!
U zhduktë nga faqja e dheut e liga për këtë vend!
Mos pafsha më ëndrra të tilla!

Çfarë shprehin fjalitë e mësipërme?

___

Në cilën mënyrë i kanë foljet kallëzues ato?

___

Cila nga fjalitë e mohon veprimin e shprehur nga folja?

___

Me çfarë shenje pikësimi përfundojnë këto fjali?

___

**2 Lexoni fjalitë nxitëse dhe përgjigjuni pyetjeve vijuese.**

Mos udhëtoni natën.
Nxito, mos u mendo gjatë!
Alban, mos merr përsipër të mbrosh shokun.
Më mirë, eja me mua.
Shkruaj më me kujdes herën tjetër.
Qetësi! Shpejt! Pa zhurmë!

Çfarë shprehin fjalitë e mësipërme?

___

Në cilën mënyrë i kanë foljet kallëzues ato?

___

Cila nga fjalitë e mohon veprimin e shprehur nga folja?

___

Me çfarë shenjash pikësimi përfundojnë këto fjali? Pse?

___

Cilat nga fjalitë nuk përmbajnë folje?

___

# Format pohore dhe mohore të fjalive

**1** **Shkruaj P përbri fjalive pohore dhe M përbri fjalive mohore.**

Ajo është vajza që fitoi olimpiadën e matematikës. ______
Në peshkim, babai nuk mori me vete asnjë. ______
Kishin ardhur të gjithë shokët e skuadrës. ______
Mësuesja nuk arriti t'i njoftonte në kohë fëmijët. ______
Merita shkëlqente gjatë stërvitjes. ______
Nuk do të shkojë asnjëri nga ne. ______
Daja më bëri dhuratë një palë kufje. ______
Mami gatuan gjithnjë supë me perime. ______
Gjyshja nuk qeshte asnjëherë me shakatë e nipërve. ______

**2** **Për secilën nga fjalitë e mëposhtme pohore, shkruani nga një fjali mohore dhe anasjellas.**

Në qytetin e vogël ishte freskët.

______________________________________________

Besmira nuk ishte sot në provimin e matematikës.

______________________________________________

Në familjen tonë të gjithë i respektojnë oraret.

______________________________________________

Tezja e Altinit nuk shkon askund e pashoqëruar.

______________________________________________

Familja e Jetmirës e kaloi fundjavën në një qytet bregdetar.

______________________________________________

**3** **Shkruani fjali pohore dhe mohore, në të cilat të përdorni fjalët:** *gjithçka, gjithkund,* **të** *gjithë, askush, asnjeri, askund.*

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

# Fjalia e përbërë

**1** **Dalloni lidhëzat bashkërenditëse dhe ato nënrenditëse në fjalinë** *"Zbuluan se ishulli ishte rreth tri milje i gjatë dhe nja treçerek milje i gjerë, si edhe nga bregu më i afërt e ndante një kanal më pak se dyqind jardë i ngushtë"*.

**Lidhëzat bashkërenditëse** _______________

**Lidhëzat nënrenditëse** _______________

**2** **Ndani në pjesë fjalitë e përbëra, thoni llojin e tyre:**

*"I hynë mirë e mirë proshutës së ftohtë, sepse i griu uria. Më vonë u ulën nën hije që të kuvendonin. Kur fliste njëri të tjerët dëgjonin me vëmendje".*

| Pjesa kryesore | Pjesa e nënrenditur |
|---|---|
| 1. | |
| 2. | |
| 3. | |

**3** **Bashkoni pjesët e fjalive të përbëra.**

| | |
|---|---|
| *Shtëpia e gjyshit është një ndërtesë,* | *për ta, i punon e i plehëron.* |
| *Ditën e ngrohin rrezet e diellit,* | *ndërsa natën bëhet strehë për fukarenjtë.* |
| *Fusha ka vetëm portokaj* | *dhe u krasit degët.* |
| *Gjyshi kujdeset gjithë kohën* | *ku strehohen të varfrit.* |
| *Atyre u lyen trungjet* | *sa të ngopet syri kur i sheh.* |

**4** **Ndani në pjesë fjalitë e përbëra, dalloni lidhëzën dhe thoni llojin.**

a) *Liza pa në ëndërr, se po binte në një pus të thellë.*
b) *Pusi ishte i frikshëm, prandaj filloi të ulërasë.*
c) *U zgjua menjëherë dhe nisi të qetësohet dalëngadalë.*

**5** **Fjalitë e thjeshta kthejini në fjali të përbëra me bashkërenditje.**

Aty-këtu vuri re piktura e harta të varura me kujdes, prandaj

_______________________________________________

Pemët i mbollën me kujdes dhe

_______________________________________________

Të gjithë i kishin veshur këpucët e tyre, por

_______________________________________________

*Ose ma dërgo librin ose*

_______________________________________________

# Kryefjala

**1** **Nënvizoni kryefjalët:**

Djali nuk dëgjoi se çfarë tha ai. U përgjigj dikush tjetër, pastaj një tjetër. Pastaj ai dëgjoi vetëm zëra burrash që flisnin e flisnin njëri pas tjetrit. Mbi kokat e tyre, shtëllungat e tymit dilnin duke u përdredhur. Biseda e tyre ishte e gjatë dhe e pafund, si litarët e shiut ditëve të shkurtit.

**2** **Plotësoni fjalitë e mëposhtme me kryefjalë.**

__________________ *punonte pa u lodhur natë e ditë.*

__________________ *kërkonte të bëhej pilot.*

__________________ *nuk e pengoi të gjente rrugën e jetës.*

*Kur u kthye nga pushimet,* ______________ *gjeti në shtëpi një qen të vogël.*

**3** **Me fjalët e mëposhtme krijoni fjali duke i përdorur si kryefjalë:**

E gjithë bota ________________________________________

Shqiponja ________________________________________

Kënga e zogjve ________________________________________

Pesë prej tyre ________________________________________

**4** **Qarkoni kryefjalët dhe tregoni me se janë shprehur:**

*Djali përsëri nuk guxonte të pyeste.* ____________________ *shprehur me:* ____________________

*Mes atij gëzimi, asnjë nuk jepte përgjigje.* ________________ *shprehur me:* ____________________

*Përpara derës së shtëpisë nuk kishte mbetur asnjë këpucë.* ________ *shprehur me:* ____________________

*Të gjithë i kishin veshur këpucët e tyre.* ________________ *shprehur me:* ____________________

**5** **Shikoni figurën dhe shkruani një tregim të shkurtër me gjashtë fjali. Nënvizoni kryefjalët.**



________________________________________

________________________________________

________________________________________

________________________________________

________________________________________

**6** **Shkruani tri fjali duke përdorur kryefjalë të shprehur me grup emëror.**

________________________________________

________________________________________

________________________________________

# Kallëzuesi

**1** **Nënvizoni kallëzuesit dhe shkruani llojin e tyre.**

Ishte hera e parë që Zhili i afrohej asaj barake të vjetër. Ajo gjendej në një vend ku asnjë nuk hynte. Përreth kishte të tillë baltë, që, në çfarëdo mënyre, asnjë nuk mund të luante pa u ndotur. Por atë mëngjes, kaloi pa u njollosur fare.

a)________ lloji:________ b)________ lloji:________ c)________ lloji:________
d) lloji:________ dh)________ lloji:________ e)________ lloji:________ f)________ lloji:________

**2** **Plotësoni fjalitë me kallëzuesit që mungojnë:**

(**Fjalë ndihmëse:** mësoi, kishin tepruar, kërceu, u nisën, vunë këmbë, ishin vënë, flakërinte)

Sapo fshatari ________ kuptimin e këtyre fjalëve, ________ i lehtësuar nga strofka e, të dy bashkë, ________ për të shijuar orët e natës brenda mureve të qytetit.

Ishte tashmë mesnatë, kur ____________________ në një pallat, ku mbi divanet e fildishta ________ një mbulesë prej mendafshi të kuq dhe shumë ushqime, që ________ nga një drekë e madhe, ________ mënjanë në shporta të mbushura plot.

**3** **Gjeni dhe vendosni në tabelë kallëzuesit foljorë dhe kallëzuesit emërorë.**

Është pranverë. Çdo gjë është përtëririë. Një tufë rrezesh shpoi perden e trashë të reve, të cilat ishin të parat që depërtuan në dhomën time të gjumit. Ky është një zgjim i bukur për një ditë të re. Fillon të ndryshojë natyra, ndryshojnë edhe njerëzit në ritmin e tyre të punës.

| Kallëzues foljor | Kallëzues emëror |
|---|---|
| | |
| | |
| | |
| | |

**4** **Plotësoni fjalitë më poshtë me kallëzues. Çfarë lloj kallëzuesish përdorët?**

Të gjithë ________________ në rrugë dhe po prisnin. ________________________________

Atë natë, ata ____________________ pasi binte shumë shi. ________________________________

Bora e maleve ______________________________ të shkrinte. ______________________________

Në parkun me lodra ____________________ shumë fëmijë. ________________________________

**5** **Lidhni grupet e fjalëve në fjali. Nënvizoni grupin e kryefjalës me një vizë dhe grupin e kallëzuesit me dy viza.**

| | |
|---|---|
| *Duart e mësuesit* | *shkollën nëntëvjeçare.* |
| *Motra e Bonës mbaroi* | *u vlerësua me njëqind pikë.* |
| *Ata të tre* | *dridheshin nga emocioni.* |
| *Kënga e fituesit* | *as nuk e dëgjuan thirrjen e shokëve.* |

**6** **Nënvizoni me një vizë tre kallëzues të thjeshtë foljor dhe me dy viza kallëzuesin e përbërë foljor.**

*Bora kapte ndonjë copë akulli, e mbante në dorë dhe, përmes saj, vështronte horizontin duke ëndërruar.*

*Një natë, Bora vendosi të nisej. Kaloi në heshtje ndërmjet mjekrës së baba Janarit, lëshoi akullin dhe e tëra mori rrugën e kodrave. Ajri ishte përzier me kristale të çuditshme. Borës filloi t'i merrej fryma.*

# Përcaktorët

**1 Dalloni përcaktorët. Me se janë shprehur?**

a) *Gjiganti i Rodit: përcaktor* _______________ *shprehur me* _________________
b) *mjeshtëri të madhe:* *përcaktor* _______________ *shprehur me* _________________
c) *i asaj kohe:* *përcaktor* _______________ *shprehur me* _________________
d) *shtatë mrekullitë:* *përcaktor* _______________ *shprehur me* _________________

**2 Nënvizoni përcaktorët. Vendosini në tabelë.**

*Me dorën e vet i çoi atij pesë kokrra rrushi të thatë dhe copëza gjysmë të skuqura proshute. Me larminë e drekës, donte të fitonte ndaj mungesës së oreksit të mikut. Me mendjemadhësinë e qytetarit, miku mezi i prekte gjërat. I zoti i shtëpisë hante grurë dhe misër për t'i lënë mikut kafshatat më të mira.*

| Përcaktor me përshtatje | Përcaktor me drejtim | Përcaktor me bashkim |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

**3 Nënvizoni përcaktorët në fjalinë *"Qetësia, heshtja e rëndë e pyllit dhe ndjenja e vetmisë filluan të ndrydhnin shpirtin e fëmijëve"*. Zëvendësojini me përcaktorë të tjerë pa humbur kuptimin e fjalisë.**

_______________________________________________

**4 Gjeni grupet emërore dhe përcaktorët e emrave bërthamë.**

*Kur zihen dy fëmijë në rrugë, ndaji, në qofshin burra, largohu, e mos e shih atë pamje të keqe.*

GE _______________________ Përcaktori _______________________
GE _______________________ Përcaktori _______________________
GE _______________________ Përcaktori _______________________

**5 Vendosini emrit *rrugë* një ndajshtim dhe përdoreni në fjali.**

_______________________________________________

**6 Me grupet e fjalëve** *"në këtë ishull, të flotës së fortë, banorët e qytetit, plan të rregullt, marinarët, Rruga e Kavajës, mësuese Mira, Shkolla "Jeronim de Rada",* **formoni fjali duke i përdorur në funksion të përcaktorit dhe ndajshtimit. Organizoni fjalitë në formën e një tregimi të shkurtër.**

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

# Kundrinorët

**1** **Dalloni kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë. Me se janë shprehur.**

Ai dilte çdo ditë me shokët dhe hidhte vështrimin nga malet.

Kundrinori i drejtë: ____________________ shprehur me ____________________________

Kundrinori i zhdrejtë: ____________________ shprehur me ___________________________

**2** **Ç'funksion kryejnë fjalët me shkronja të zeza? Me se janë shprehur?**

U ul në bankën time duke ***më*** kthyer ***kurrizin***.

më ____________________ shprehur me ________________________________________

kurrizin ____________________ shprehur me _____________________________________

**3** **Shkruani fjali ku të përdorni tre kundrinorë të drejtë të shprehur me: emër, përemër, GE.**

a) ______________________________________________________________________________

b) ______________________________________________________________________________

c) ______________________________________________________________________________

**4** **Plotësoni fjalitë e mëposhtme me pjesën që i mungon, e cila të jetë kundrinor.**

Mësuesi këshilloi _______________ për ditën e festës.

Klausi e pëlqen shumë _______________ .

Marta e do shumë _______________ .

**5** **Bazuar në ilustrimin përbri, formoni pesë fjali ku të përdorni kundrinorë. Nënvizojini ata.**

__________________________________________________________

__________________________________________________________

__________________________________________________________

__________________________________________________________

__________________________________________________________

__________________________________________________________



**6** **Dalloni kundrinorët, përcaktoni llojin e tyre.**

*Sapo fshatari mësoi kuptimin e këtyre fjalëve, kërceu i lehtësuar nga strofka e, të dy bashkë, u nisën për të shijuar orët e natës brenda mureve të qytetit.*

*Ishte tashmë mesnatë, kur vunë këmbë në një pallat, ku mbi divanet e fildishta flakërinte një mbulesë prej mëndafshi të kuq dhe shumë ushqime, që kishin tepruar nga një drekë e madhe, ishin vënë mënjanë në shporta të mbushura plot.*

# Rrethanorët

**1** **Nënvizoni rrethanorët dhe vendosini në tabelë sipas llojit:**

*Vlera për lapsin nuk është vetëm veshja e drurit apo forma e tij e jashtme, por karboni që është brenda. Kujdesu gjithnjë për të pasuruar botën tënde! Tipar i lapsit është se ai lë gjurmë. Si lapsi edhe ti duhet të kuptosh qartë, se çdo gjë që ti bën në jetë, lë gjurmë. Përpiqu shumë, përpiqu të jesh gjithmonë i ndërgjegjshëm për çdo veprim që bën! Njeriu vlerësohet nga veprimet e jo nga fjalët.*

| Vendi | Kohe | Qëllimi | Shkaku | Mënyre | Sasie |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |

**2** **Në ç'funksion është përdorur emri *rrugë* në këto fjali?**

a) Shiko më mirë kur të ecësh ***në rrugë***. Funksioni ______________________________

b) Nderoje ***rrugën***! Funksioni ______________________________

c) Shikoji me respekt të gjithë fëmijët, që shkojnë ***në rrugën e dijes.*** Funksioni ________________

**3** **Gjeni funksionin e gjymtyrëve të fjalisë dhe thoni me se janë shprehur:**

Mësuesi i mblodhi shpejt e shpejt detyrat.

a) mësuesi ______________________________

b) i ______________________________

c) mblodhi ______________________________

d) shpejt e shpejt ______________________________

e) detyrat ______________________________

**4** **Ç'lloj rrethanorësh janë fjalët me shkronja të zeza?**

a) Shikoji ***me dashuri*** të gjithë fëmijët. Lloji ____________________

b) ***Para teje*** po kalonte Dea dhe Etieni. Lloji ____________________

c) Mos harro, po ta kesh ***vëth në vesh***. Lloji ____________________

d) S'është mirë kur luajnë ***dy*** fëmijë në rrugë. Lloji____________________

**5** **Shkruani një tregim të shkurtër me titull *"Një fletë nga ditari im"* .**
**Përdorni gjashtë rrethanorë të ndryshëm.**

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

# Referenca


- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës 9 e rishikuar), Prishtinë, Gusht 2016
- Kurrikula lëndore/programi mësimor për lëndën Gjuhë shqipe 6 – Gusht 2018
- Kurrikula bërthamë e arsimit të mesëm të ulët të Kosovës, Gusht 2016
- N. Mjeda - Vjersha për të vegjël, Naim Frashëri, Tiranë, Shqipëri 1967.
- R. Qosja - Antologji e lirikës shqipe - Prishtinë 1970
- Gjuha letrare shqipe, (Pjesë nga poezia shqipe dhe pasqyra gramatikore) - Tiranë Shqipëri 1989.
- Z. Rrahmani - Njohuri nga teoria e letërsisë – Tiranë, Shqipëri, 1996
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë - *Fjalor i gjuhës shqipe,* Tiranë, Shqipëri 2006
- B. Beci - *Për një konceptim bashkëkohor të mësimit të gjuhës amtare në shkollë"* - "Gjuha jonë", ASH, IGJL, Tiranë, Shqipëri 1993
- N. Chamsky - *Aspects of the theory of Syntax* - MIT Press, *Boston* 1965
- Chaney, T. Burk - *Teaching Oral Communication in grades K-8,* 1998
- Prof.Dr. M. Gjokutaj - *Didaktika e gjuhës shqipe,* Tiranë, Shqipëri, 2009
- Prof.Dr. M. Gjokutaj, Dr. Nj. Kazazi - *Prirja e sotme për mësimin e gjuhës shqipe,* Shkodër, 2003
- Prof.Dr. M. Gjokutaj, N.Mërkuri - *Modele të suksesshme mësimdhënieje* - Tiranë, Shqipëri 2008
- Prof.Dr. M. Gjokutaj, *Probleme të sotme të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë* - Tiranë, Shqipëri, 2001
- K. Grillo - *Fjalor edukimi* - Tiranë, Shqipëri 2002
- R. Memushaj - *Shqipja standarde* - Botimet Toena Tiranë, Shqipëri, 2005
- R. Gjoshi - Didaktika e gjuhës shqipe, Prizren, Kosovë, 2017
- R. Gjoshi - Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë(aspekte historike dhe didaktike), Prishtinë,2016.
- Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe,* Tiranë, Shqipëri, 2007
- https://www.dreamstime.com/